

ASI

A S S E M B L Y S U P P O R T I N I T I A T I V E

Newsletter

Dhjetor 2003, No 09

osce
Mission in Kosovo

- Anëtarët e parlamenteve të Evropës Juglindore takohen në Sarajevë
- Tri parlamente mbështesin Kuvendin e Kosovës
- Ligji kundër diskriminit në shqyrtim

Ngja redaktori

Me 3 nëntor të vitit 2003 në Sarajevë, u zhvillua një ngjarje e mrekullueshme. Parlamentarët nga Evropa Juglindore u takuan në rezidencën e "Konak"-ut, vendin ku më 1914 vdiq Franc Ferdinandi, trashëgimtari i fronit të Austro-Hungarisë. Sulmi ndaj tij ishte ngjarja kryesore që i parapriu Luftës së Parë Botërore. Pothuaj nëntëdhjetë vjet më vonë në të njëjtin vend, parlamentarët nga i tërë rajoni, nga Vjena në Sofje, dhe nga Tirana në Beograd, u mbledhën për të diskutuar mbi sfidat e përbashkëta të zhvillimit shoqëroro-ekonomik dhe të luftës për zvogëlimin e varfërisë.

Me këtë rast, anëtarët e delegacionit të Kosovës, që kryesohej nga prof. Daci, u takuan me homologët e tyre nga 10 parlamente tjera. Karakteri i shumëanshëm i kësaj konference, që u organizua nga OSBE-ja, bëri të mundur që, gjatë këtij takimi pune, jo vetëm të diskutohej në rrafshin teknik, por edhe të bëhej prezantimi i ekspertizës së komisioneve të specializuara dhe deputetëve nga Kosova dhe Serbia. Artikujt që sjell ky numër i Buletinit ofrojnë informata më të hollësishme mbi këtë ngjarje si dhe komente të ndryshme lidhur me konferencën dhe rezultatet e saj, duke theksuar nevojën që deputetët e Kuvendit të Kosovës të angazhohen më tepër në dialogun e drejtpërdrejtë për çështje praktike me kolegët e tyre nga rajoni.

Megë ky është numri i fundit i buletinit të ASI-it për këtë vit, në te kemi sjellur mjaft informacione jo vetëm mbi aktivitetet e nduaruarta që janë zhvilluar në lëmin e kualifikimit të kuadrove të Kuvendit, por edhe informacione lidhur me prezantimin e programit për mbështetje nga tri parlamente, të financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER). Veç kësaj, në këtë numër ju mund të lexoni edhe intervista me deputetët dhe artikujt të ndryshëm nga deputetët e Kuvendit, si dhe intervistën me Ministrin e Arsimit, i cili, kohë më parë tok me anëtarët e Komisionit të Kuvendit për Arsim bëri një vizitë në Gjermani.

Departamenti për Demokratizim i OSBE-së dhe të gjitha organizatat tjera partnere në Iniciativën për Mbështetje Kuvendit Qendror (ASI) janë zotuar se do vazhdojnë ta japin kontributin e tyre për avansimin e punës së Kuvendit. Në këtë numër kemi sjellë disa informata lidhur me këtë. Vërejtjet tuaja janë të gjithnjë të mirëpritura.

Franklin De Vrieze,
Koordinator i Iniciativës për Mbështetje Kuvendit Qendror.

Faleminderit, Friedhelm dhe Rita !

Pas dy vjet e gjysmë pune të përkushtuar në Kosovë Dr. Friedhelm Frischenschlager do të kthehet në Austri. Si ish-Ministër i Mbrojtjes së Austrisë dhe ish-anëtar i Parlamentit Evropian, Dr. Frischenschlager i kontribuoi shumë punës së Misionit të OSBE-së në Kosovë, fillimisht si kryesues i Sektorit të Partive Politike dhe më pas edhe si Drejtor i Departamentit për Demokratizim. Ai i ndoqi për së afërmi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe inkurajoi punën e Iniciativës për Mbështetje Kuvendit Qendror (ASI).

Edhe Rita Taphorn do të largohet nga Kosova. Ajo punoi për më shumë se tri vjet në Misionin e OSBE-së në Kosovë, fillimisht në Departamentin e Operacioneve të Zgjedhjeve, pastaj në Ekipin për Mbështetje Kuvendit Qendror pranë Departamentit për Demokratizim të OSBE-së. Rita me energjinë dhe entuziazmin e saj të veçantë, jo vetëm që mundësoi takime me deputetët të Kuvendit dhe kuadrot e tij, por dha edhe një kontribut të konsiderueshëm në aktivitetet rreth koordinimit të punës me parlamente të ndryshme, fondacione dhe zyra shtetërore. Ajo ka qenë njëra nga zyrtaret më të angazhuara në radhët e Iniciativës për Mbështetje Kuvendit Qendror (ASI-t) dhe prandaj gëzon një respekt të veçantë nga deputetët dhe kuadrot e Kuvendit të Kosovës.

Friedhelm dhe Rita, ne u jemi shumë mirënjohës për kontributin tuaj. Ju dëshirojmë fat të mbarë në angazhimet tuaja gjatë viteve të ardhshme. Shpresojmë se ju edhe në të ardhmen do ta vizitoni Kosovën.



Tri parlamente mbështesin Kuvendin e Kosovës

Kohë më parë ka filluar realyimin i një programi 18 muajsh të Agjencisë Evropiane për Rindërtim (AER) për mbështetje Kuvendit të Kosovës. Një konsorciumi që përbëhet nga parlamentet e tri vendeve evropiane, Kuvendi Kombëtar Francez, Bundestag-u gjerman dhe Dhoma Belge e Përfaqësuesve, në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar i Parisit "La Defense" (Mbrojtjes) i është besuar zbatimimi i këtij programi. Kohë më parë, një ekip ekspertësh në krye me Z. Nicolas Maziau-n, profesor i së Drejtës Publike në Francë, filloi me punë rreth zbatimit të këtij programi. Me këtë rast, ASI bisedoi me profesorin dhe me dy anëtarët e ekipit të tij, Z. Alfred Drescher, ish-Kryesues i Personelit në Bundestagun gjerman dhe prof. Hajrih Grose-Sender, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Landtagut të Rhine-Westfalia-s veriore.

Intervistën e zhvilloi: David Buerstedde, Zyra për Çështje Politike e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Fillimisht, prof. Maziau, a mund të na tregoni diçka për ekipin që do ta vë në jetë projektin?

Nicolas Maziau: Ekipi përbëhet nga udhëheqësi i ekipit, tre ekspertë kryesorë, dy nga të cilët janë sot me ne dhe i treti, Z. Peter Vanhoutte-it, ish-anëtar i Dhomës Belge të Përfaqësuesve, që do të jetë përgjegjës për të gjitha çështjet e prokurimit dhe logjistikës. Në përbërjen e ekipit janë edhe dy asistentë administrativë, dy përkthyes dhe një ekspert vendor ligjor detyra kryesore e të cilit do të jetë që ta kontrollojë përputhshmërinë e legjislacionit të Kosovës me standardet evropiane. Pos kësaj, ne do të bashkëpunojmë edhe me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë, të cilët do t'i angazhojmë për kohë më të shkurtë.

Me cilët ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë do të konsultoheni?

N.M.: Ne jemi në procesin e identifikimit të ekspertëve vendorë nga qarqet akademike dhe segmentet tjera të shoqërisë. Qëllim ynë nuk është që t'i ofrojmë vetëm

një përvojë të rëndësishme Kuvendit, por edhe që të sigurohemi se Kuvendi ka për t'i ruajtur dhe avansuar lidhjet e veta me shoqërinë civile. Sa u takon ekspertëve ndërkombëtarë, është me rëndësi të vihet në dukje se të gjithë ekspertët që janë angazhuar në këtë projekt janë shërbyes civilë, shumica prej të cilëve do të jenë nga tri parlamentet e përfshira në projekt. Vetë fakti se shërbyesit civilë të angazhuar në këtë program nuk janë këshilltarë privatë, gjë e cila ndodh shpesh me programet që drejtohen nga Bashkësia Evropiane, do të sjellë një qasje tjetër ndaj raporteve të deputetëve të Kuvendit dhe stafit të tyre. Këta ekspertë janë njerëz që janë të lidhur ngusht me institucionet e tyre përkatëse në vendet prej nga vijnë, së këndejmi do t'u mundësojnë zyrtarëve të Kuvendit që jo vetëm të mësojnë nga përvoja e drejtpërdrejtë e tyre, por edhe të krijojnë marrëdhënie të atilla, të cilat shpresojmë se do të mbesin të afërta madje edhe pas implementimit të këtij projekti. Unë sinqerisht shp-



Prof. Nicolas Maziau

resoj dhe pres që ekspertët me kontratë afatshkurtë do t'u kthehen institucioneve të tyre përkatëse me kujtimit të mira dhe simpati për Kosovën dhe Kuvendin e saj.

A ka konsorciumi i parlamenteve, të cilin e përfaqësoni, ndonjë përvojë të ngjashme të punës në Evropën Juglindore apo edhe në vende tjera?

N.M. Ç'është e vërteta, ka. Kështu, në vitin 1996 French Assemblée Nationale [Kuvendi Kombëtar i Francës] për herë të parë morri pjesë në një program të ngjashëm të

BE-së. Këtë program e realizoi në bashkëpunim me Bundestagun gjerman dhe Dhomën e Deputetëve Spanjollë për ta ndihmuar Dumën Ruse. Vlen të theksohet se gjatë viteve të fundit ka pasur një mori iniciativash të tilla shumëpalëshe.

Çfarë keni arritur të bëni deri më sot?

N.M.: Deri më sot ne kemi mbajtur konsultime, të cilat janë me interes vendor dhe ndërkombëtar, dhe ç'është më e rëndësishmja, kemi mbajtur konsulta brenda Kuvendit. Gjatë kësaj kohe ne kemi hasur në një vullnet të madh për bashkëpunim dhe ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur me mbështetjen që na është ofruar deri më tani. Njëherësh, i jemi mirënjohës Bordit Këshilldhënës, që u formua për të na udhëzuar gjatë punës.

Kush përfaqësohet në Bordin Këshilldhënës?

N.M.: Në radhën e anëtarëve hyjnë përfaqësues nga AER-i, Zyra e Evropës dhe

Konsorciumi. Ndërkaq, nga Kuvendi prof. Fatmir Sejdiu përfaqëson Kryesinë e Kuvendit, kurse Z. Jusuf Demaj, Sekretariatit e Kuvendit. Bordi Këshilldhënës do të takohet çdo tre muaj për ta shqyrtuar dhe vlerësuar implementimin e projektit.

E pra, cilët janë qëllimet kryesore të programit?

N.M.: Krahas rinovimit të godinës së Kuvendit, programi ka për qëllim ofrimin e ndihmës teknike departamenteve të Sekretariatit. Kështu, Departamentit të Administratës do t'i ofrohet ndihmë rreth personelit, buxhetit dhe prokurimit, ndërsa ndihma në kuadrin e Departamentit për Çështjeve Ligjore, do të përqëndrohet në Zyrën për Parashpresa dhe në Seksionin për Mbështetje Komisioneve. Me këtë rast, do të bëhet një rishqyrtim i përgjithshëm i rregullave ekzistuese si dhe një elaborim i mëtejshëm i kornizës së brendshme rregullative të Kuvendit, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe emulacionit të zbatimit të legjislacionit, por edhe të shtimit të autonomisë

financiare dhe administrative të Kuvendit.

Alfred Drescher: Do të doja të theksojë me këtë rast se sa e rëndësishme është për një sistem funksional demokratik, që legjislacioni të jetë i pavaruar nga ekzekutivi. Kjo vlen edhe për trajnimin e stafit të Sekretariatit të Kuvendit. S'do mend se çdo Kuvend që e respekton vetveten, do të bënte çmos që stafin e vet ta trajnojë sipas rregullave të veta.

A do të ketë ndryshime edhe në Rregulloren e Punës me rastin e ndryshimeve të rregullave të brendshme të punës?

Heinrich Grosse-Sender: Rregullorja e Punës është kryesorja për funksionimin e Kuvendit. Së këndejmi, kjo Rregullore kohë pas kohe duhet të ndryshohet dhe të përshtatet me praktikën e reja parlamentare. Ne e dimë se Rregullorja e Punës e Kuvendit ka qenë temë e një debati të gjallë gjatë viteve të fundit. Mirëpo, ne as nuk kemi marr pjesë në këtë debat dhe as nuk do të dëshironim t'ia mbajmë anën askujt, por po që nevoja, do t'i japim vërejtjet tona.

Rregullorja e Punës është bërë një çështje politike. Ju mund të jeni të shtrënguar që të ofroni këshilla edhe për çështje tjera të ndjeshme politike. Si do të veproni në këso rastesh?

N.M.: Roli ynë është teknik, e jo politik. Ne nuk kemi një rend dite të përcaktuar. Detyra jonë është që para së gjithash t'i ndihmojmë Kuvendit të funksionojë sa më mirë. S'do mend se, çfarëdo vendimi që merret sipas këshillave tona, mund të bëhet çështje politike, ndonjë kjo mund të bëhet pa dashje. Megjithatë, është një çështje, të cilën si të thuash e kemi në zemër dhe, në favor të së cilës padyshim do të inkurajojmë marrjen e disa vendimeve të rëndësishme politike. E kam fjalën këtu për sigurimin e përputhshmërisë së legjislacionit kosovar me *acquis communautaire*, një tërësi rregullash të hartuara nga Bashkësia Evropiane, njohja dhe zbatimi i të cilave kërkohet nga të gjitha ato vende, të cilat dëshirojnë të aderojnë në BE.

A mendoni se do të duhej të ishte përgjegjësi e qeverisë, që me rastin e dorëzimit të një projektligji, të përkujdeset vetë që drafti të jetë në pajtim me *acquis communautaire*?

H.G-S.: Afër mendsh, nëse qeveria e propozon projektligjin, atëherë ajo duhet të jetë vetë përgjegjëse për të si dhe për objektivat tjera të deklaruara, të cilat duhet të përmbushen, nëse synohet integrimi në Evropë. Siç do të kuptoni më vonë, AER është duke e realizuar edhe një program tjetër mbështetës

në Zyrën e Kryeministrit, i cili përqëndrohet në nevojën për zbatimin e *acquis*. Kjo do të ketë rëndësi thelbësore për zgjerimin e bashkëpunimit me qeverinë në të gjitha iniciativivat për ligjvënien. Sidoqoftë, Kuvendi është institucioni ku projektligjet bëhen ligje, prandaj ne pikërisht këtu do ta përqëndrojmë asistencën tonë. Njëkohësisht, ne shpresojmë se Kuvendi do ta shfrytëzojë më shumë të drejtën e tij për të inicuar legjislacionin e vet, siç ndodhi me projektligjin mbi barazinë gjinore.

Bashkëpunimi me qeverinë është çështje në vete. Si i vlerësoni ju marrëdhëniet e Kuvendit me UNMIK-un?

N.M.: Duket sheshit se ka ende vend për përmirësim. Ndërkaq, ky është një problem kryesisht politik, i cili tejkalon suazat e ndikimit tonë të kufizuar. Ne do të punojmë së bashku me Ekipin e AER-it për Mbështetje Zyrës së Kryeministrit, për t'i përmirësuar marrëdhëniet midis të gjitha institucioneve që kanë një rol në procesimin e legjislacionit. Sikurse edhe në qeveri, edhe këtu duhet të precizohet më qartë se kur dhe në çfarë rastesh UNMIK-u mund të intervenojë gjatë procesit ligjvënës.

Si do të ndikojnë zgjedhjet e vitit të ardhshëm në programin tuaj për mbështetje? A mendoni se do të hasni në ndonjë vështësi?

H.G-S.: E vetmja vështësi që mund të kemi është se deputetët e Kuvendit mund të jenë të zënë me fushatën elektorale, prandaj edhe nuk do të mund të punonin me ta para zgjedhjeve. Nga ana tjetër, periudha e zgjedhjeve do të na mundësojë për të punuar më shumë me stafin e Sekretariatit. Prandaj, me që vëmendja do të përqëndrohet kryesisht tek zgjedhjet, ne do të bëjmë çmos që së paku Kuvendi i ri i zgjedhur të ketë një Sekretariat, që deri atëherë dukshëm do t'i përmirësonte shërbimet e tij. Veç kësaj, pas zgjedhjeve ne do ta përgatisim një kurs fillestar dhe një udhëzim orientues për deputetët e rinj të Kuvendit - shkurt,

siç po shihni zgjedhjet janë bërë pjesë e procesit tonë të planifikimit. Një nga avantazhet më të mëdha të projektit tonë është se ai do të vazhdojë edhe pas zgjedhjeve të vitit të ardhshëm.

Edhe aktivitetet tjera që janë koordinuar përmes Iniciativës për Mbështetje Kuvendit i kanë ofruar mbështetje Kuvendit që nga themelimi i tij. Si do të siguroheni se aktivitetet tuaja të jenë plotësuere në raport me përpjekjet e IMK-së?

N.M.: IMK ka bërë shumë gjatë viteve të kaluara dhe ne kemi përfituar shumë nga përvoja dhe memorja institucionale e organizative që i janë bashkuar kësaj iniciative. Ne tani jemi duke marrë pjesë rregullisht në diskutimet e IMK-së, jo thjesht për të këmbyer informata, por edhe për të vënë në jetë projekte të përbashkëta.



Prof. Heinrich Grosse-Sender dhe Mr. Alfred Drescher

KOMISIONI PËR ARSIM VIZITON GJERMANINË

Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) ka zgjeruar programin arsimues të këshillëdhënies dhe ekspertëve për Kosovën, duke saktësuar se përgjegjësitë dhe kompetencat të transferohen nga UNMIK-u tek autoritetet vendore. Ky proces i transferimit ka qenë i mbështetur nga KAS-i përmes një ftese të anëtarëve të Komisionit parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Z. Rexhep Osmani, dhe Kryetari i Kuvendit, Profesor Nexhat Daci, për një vizitë njëjavore në Berlin prej datës 20 deri me 27 shtator 2003.

Dr. Bernhard Lamers, Konrad Adenauer Foundation Kryesues i Zyrës Rajonale

Një sektor esencial dhe i rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të çdo shoqërie është arsimimi dhe veprimtaria hulumtuese, që tanimë është pjesë përbërëse e juridiksionit të ministrisë kompetente dhe Kuvendit të Kosovës. Qëllimi i ekspertëve të KAS-it dhe i programit këshillëdhënës në Gjermani ishte që t'ia mundësojë Komisionit parlamentar, Ministrin dhe kryetarit të Kuvendit që të zhvillojnë diskutime dhe biseda me ekspertë të ndryshëm dhe politikanë të partive të ndryshme politike të Gjermanisë, në mënyrë që të përfitojnë një përvojë të re në marrëdhëniet e ndërsjella të forcave ekzekutive dhe ligjvënëse. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë marrë një pasqyrë nga diskutimi mbi realitetin në lëmin e politikave arsimore në Gjermani.

Raportet hyrëse kanë ofruar një pasqyrë të diskutimit në lëmin e politikave arsimore dhe strukturën organizative të sistemit arsimues. Është theksuar synimi për realizimin e procesit educa-

tivo-arsimor për zhvillimin e personalitetit të studentit. Bazuar në Deklaratën e Bolonjës, evropianizimi i arsimit universitar pritet të realizohet në tërë Europën. Vëmendje e posaçme i është kushtuar rolit të Qeverisë dhe Parlamentit në zhvillimin e strukturave të reja arsimore gjatë transferimit të ish sistemit socialist edukativo-arsimor të Gjermanisë Lindore në sistem modern. Përvoja praktike politike është ligjëruar nga Profesor Shipanski, Ministër i Shkencës në Provincën e Thueringenit dhe nga ish përfaqësuesja e UNMIK-ut për arsim, shkolla dhe universitete, Znj. Stefi Leimërs.

Vizita e studiuese ka paraparë edhe vizita institucioneve edukative si dhe biseda me mësimdhënës dhe drejtorë për zhvillimet praktike, problemet dhe përvojat në sistemin shkollor të Gjermanisë. Çështjet delikate, si integrimi i fëmijëve të huaj në sistemin shkollor të Gjermanisë apo menaxhimi i konfliktit, janë diskutuar në mesin e nxënësve. Përgatit-



jet e të rinjve gjatë pushimit janë trajtuar përmes një prezentimi të detajizuar të të ashtuquajturit 'sistem i dyfishtë' që njëson arsimimin praktik dhe shkollor. Anëtarët e Parlamentit sigurisht që nuk do të harrojnë vizitën në një shkollë fillore ku 15 fëmijë nga 12 nacionalitete të ndryshme mësojnë së bashku në paqë gjermanisht.

meqë një qendër e ngajshme planifikohet të ndërtohet edhe në Prishtinë.

Anëtarët e Parlamentit patën rastin të bisedojnë edhe me një numër politikanësh: mes tyre edhe deputetët nga Partia Demokratike Kristiane Peter Hintze, Peter Weiss dhe Dr. Pflueger për t'u njohur më për së afërmi me zhvillimet politike në Gjermani dhe për të shpre-

Vizita në Universitetin Teknik të Drenit, si dhe vizita në Qendrën Teknologjike të Adlershofit në Berlin, i ka paraparë përfundimit të programit. Mësimet dhe porositë e nxjerra nga Fondacioni në Qendrën Teknologjike Adlershof, ishin shumë të rëndësishme për parlamentarët kosovarë

hur shpresat e tyre politike nga Bashkësisia Ndërkombëtare lidhur me ardhmërinë e Kosovës. Vizita në Ministrinë e Punëve të Jashtme ka ofruar mundësinë për vazhdimin e dialogut intensiv mes përfaqësuesve të Gjermanisë dhe Kosovës.

Për shumicën e pjesëmarrësve kjo ishte vizita e parë në Berlin. Koncepti i vizitës - për të gërshtuar vizitën e ekspertëve me vizitën praktike - ka qenë shumë produktiv dhe pozitiv, meqë shumë deputetë të parlamentit punojnë në lëmin e edukimit dhe të arsimit. Përvoja jonë gjermane, situata specifike në qytetin multietnik të Berlinit dhe sfidat e dala gjatë procesit të integritimit, mund të merren si një 'laborator' i dobishëm për çështjet që presin për t'u zgjedhur sot në Kosovë.

Realizimi i sukseshëm i programit inkurajon KAS-in të vazhdojë angazhimin e tij në Kosovë në lëmin e arsimit përmes këshillëdhënies, seminareve dhe programit të dialogut.

Sigurimi i cilësisë dhe fillimi i reformave në sektorin e arsimit

Z. Rexhep Osmani (LDK) është ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në qeverinë e Kosovës. Ai ka qenë njëri ndër figurat kryesore në arsim për më shumë se një dekadë. Me këtë rast, ne e vizituam atë në një ambient tjetër, në kabinetin e vërtetë ministror - si ministër. Z. Osmani e presin shumë sfida. Së pari, atij i duhet t'u jap shtysë reformave në arsim dhe t'i riparojë dëmet në jetën intelektuale që janë shkaktuar nga vitet e gjata të aparteidit; dhe së dyti ta sigurojë njohjen e Ministrisë së tij nga gjitha komunitetet.

Intervistën e zhvilluan Edita Bucaj dhe Rita Taphorn, OSBE

P. Z. Osmani, çfarë rëndësie ka vizita e juaj e fundit në Gjermani? Si mund ta zbatoni atë përvojë në Kosovë?

Pgj. Ne bëmë një vizitë të Gjermanisë prej datës 17 deri më 27 shtator dhe fillimisht morëm pjesë në një konferencë të ministrave të Evropës mbi shkollimin e lartë. Për Kosovën, ky ka qenë një takim shumë me rëndësi. Kjo ishte hera e parë që përfaqësuesit e Kosovës marrin pjesë në një konferencë të ministrave, edhe pse në cilësinë e vëzhguesve.

Në konferencën përcjellëse, që do të mbahet në Bergen të Norvegjisë në vitin 2005, Kosova do të pranohet si anëtare me të drejta të barabarta në Procesin e Bolonjës (për reformimin e sistemit universitar). Kosova do të përpiqet për t'i përmbushur kriteret për t'u bërë anëtare e këtij procesi - të sigurojë cilësi në shkollimin e lartë dhe t'i fillojë reformat në Universitetin e Prishtinës.

Vizita në Gjermani u ndihmua nga Fondacioni gjer-



Para ndërtesës së Parlamentit të Saksonisë së Poshtme (Gjermani): Znj. Venera Lllunji, nga Ministria e Arsimit; Z. Rexhep Osmani, Ministër i Arsimit; Z. Juergen Gansauer, Kryetar i Parlamentit të Saksonisë së Poshtme; Prof. Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës; Znj. Rita Taphorn, nga OSBE-ja dhe Znj. Zoja Osmani, nga Kuvendi i Kosovës.

man Konrad Adenauer dhe u përkrah nga OSBE-ja. Me këtë rast, delegacioni ynë, anëtar i të cilit isha edhe unë dhe që përbëhej nga Komisioni i Kuvendit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji dhe Kryetari i Kuvendit Profesor. Daci, vizitoi Bundestagun gjerman dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Atje, patëm rastin të takohemi më parë me parlamentarë të ndryshëm, pastaj edhe me ekspertë të arsimit, të cilët folën për sistemin gjerman të shkollimit. Kjo vizitë që e dobishme jo vetëm për komisionin e Kuvendit, por edhe për Ministrinë, ngase patëm rastin që të njihemi me problemet, brengat dhe përvojat e dobishme të sistemit arsimor gjerman.

Përpos kësaj, me ftesën e kryetarit të Parlamentit rajonal të Saksonisë së ulët, Professor Daci dhe unë zhvilluam disa takime në qytetin e Hanoverit, me ç'rast diskutuam lidhur me disa projekte konkrete për përkrahjen e arsimit.

P. A ka Ministria ndonjë politikë të qartë për shkollimin në Kosovë, përshirë këtu politikat për shkollimin e të gjitha bashkësive dhe të gjitha niveleve të arsimit?

Pgj. Ministria ka një strategji zhvillimi për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2007.

Strategjia e saj po zbatohet në segmente të ndryshme, siç janë programet, librat e leximit, trajnimet për mësues dhe veprimtaria për përmirësimin e sistemit të shkollimit në të gjitha nivelet për të gjitha grupet etnike në Kosovë.

P. A vlen kjo edhe për Universitetin në veri të Mitrovicës?

Pgj. Të gjitha minoritetet janë integruar në këtë sistem dhe i kanë pranuar programet e Ministrisë për mësim dhe zhvillim, përveç minoritetit serb, i cili funksionon në mënyrë paralele. Në veri të Mitrovicës sistemi paralel është ende duke funksionuar, si është theksuar edhe në raportin e fundit të OSBE-së, dhe një gjë e këtillë po shkakton probleme serioze.

P. A duhet të merret Ministria juaj me këtë problem, meqë ajo ka si autoritetin ashtu edhe kompetencat ta bërë një gjë të këtillë?

Pgj. Ministria nuk mund t'i zgjidhë problemet që duhet të zgjidhen në nivelin politik - nga UNMIK-u, Kuvendi dhe Qeveria. Ministria ka bërë përcapje që të japë kontributin e saj për t'u ndihmuar komuniteteve, nënkuptohet edhe komunitetit serb. Mirëpo, ata jo vetëm që nuk duan ta njo-

hin autoritetin e Ministrisë së Arsimit, por as nuk dëshirojnë të komunikojnë me ne. Së këndejmi, është vështirë t'i ndihmohet dikujt që nuk të pranon.

P. Në qoftë ashtu, kush mendoni se duhet ta marrë rolin kryesor në këtë iniciativë? Çfarë duhet të jetë roli juaj si Ministri?

Pgj. Mendoj se është detyrë e institucioneve të larta të Kombeve të Bashkuara dhe e vetë qeverisë së Serbisë për të ndaluar funksionimin e këtyre strukturave. Ministria tanimë i ka krijuar kushtet për të gjithë ata që të inkuadrohen në sistem. Ne ua japim pagat. Njëehërsh, ne i kemi hartuar plan-programet e reja në të katër gjuhët (shqipe, boshnjake, serbe dhe turke). Kështu, Ministria është duke i ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme, por pakica serbe përpos pagave, asgjë tjetër nuk ka pranuar.

P. Por, komuniteti serb është duke u ankuar se u mungojnë tekstet në gjuhën amtëtare? Sa kohë i duhet Ministrisë që t'ua sigurojë tekstet?

Pgj. Tekstet shkollore nuk mund të sigurohen pa plan-program. Ne e kemi hartuar planprogramin dhe e kemi shpallur konkursin për sigurimin e teksteve mësimore dhe të shohim se si

do të shkojë puna. Tekstet mësimore mund të hartohen edhe në Kosovë, por për disa lëndë, siç janë historia, letërsia dhe për lëndët, të cilat janë me rëndësi për identitetin e tyre kulturor, mund të përdoren edhe tekste shkollore nga vendet e tjera, me kusht që të jenë në gjuhën e amtëtare.

P. Si mund të përdorin libra nga jashtë kur dihet se tanimë ka kërkesa që librat e historisë së Kosovës të ndryshohen?

Pgj. Kjo çështje është ekzagjeruar nga ana e mediave për interesat e tyre. Ne u përmbahemi frymës së kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Evropës, sipas të cilave kërkohet modifikimi i teksteve mësimore të historisë apo përgatitja e teksteve të historisë që janë të xhveshura nga gjuha nxitëse apo urrejtëse. Kjo është e tëra që kërkohet dhe afër mendsh është e pranueshme për ne. Përkundër deklarimeve në media, ne jemi ata të cilët do të vendosim se çfarë gjuhe do të përdoret në tekstet shkollore të historisë që do të shfrytëzohen nga fëmijët tanë, jo vetëm të shqiptarëve të Kosovës, por edhe të të gjitha pakicave të tjera që jetojnë në Kosovë.

P. Çfarë janë marrëdhëniet e qeverisë së Kosovës me

Ministrinë e Arsimit ?

Pgj. Qeveria e Kosovës fuksionon si një tërësi. Kjo është një qeveri e koalicionit dhe deri më tani nuk ka pasur ndonjë problem të madh, prandaj unë mendoj se ne kemi marrëdhënie të mira pune. Kjo vlen edhe sa i takon marrëdhëniet me Kryeministrin, përkundër tensioneve të ngritura kohëve të fundit lidhur me çështjen e dialogut. Kryeministri nuk ndërhyt siç ndërhyt disa këshilltarë të tij politikë kur Ministria ishte ende në fazën e konstitutumit. Ai tanimë e ka të qartë se janë ministri dhe Ministria ata që duhet të jenë përgjegjës për fushën e arsimit dhe jo Zyra e Kryeministrit.

P. Për çfarë u përdorën donacionet e Bankës Botërore dhe "Programi për trajnimin e mësimdhënësve kosovarë", KEDP?

Pgj. Banka Botërore ka dhënë 4.5 milion dollarë, nga të cilat deri më tani kanë përfutur 10 shkolla. Projekti pilot për të inkurajuar vijimin e mësimin ka përfunduar. Mirëpo, KEDP na ka njoftuar se do ta vazhdojë projektin e tij deri në vitin 2007, në shumën prej 4.5 milion dollarësh, e cila do t'i jipet kryesisht Kosovës, por një pjesë do t'i jipet edhe Serbisë.

"Legjislacioni penal i Kosovës është model për Evropën Juglindore"

Intervistë me Prof. Dr. Arsim Bajramin, Kryetar i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe të Kornizës Kushtetuese

Intervistën e zhvilluan Edmond Efendija nga NDI dhe Franklin De Vrieze nga OSBE

Z. Bajrami, cili është roli kryesor i Komisionit që ju e udhëhoqi në procesin legjislativ dhe a është përmbushur ky rol?

Komisioni për Çështje Legjislative, Gjyqësore dhe Kornizë Kushtetuese si funksion primar ka kontrollin e bazueshmërisë kushtetuese të ligjeve që i miraton Kuvendi i Kosovës dhe pajtushmërinë e këtyre ligjeve me standardet evropiane. Së këndejmi, ne së pari i verifikojmë se a janë ligjet që i miraton Kuvendi i Kosovës konform Kornizës Kushtetuese, dhe njëherësh bëjmë edhe kontrollimin rutinor të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare.

Një prej sfidave kryesore për Kuvendin në vitet që vijjnë është që të sigurohet harmonizimi i ligjeve të miratuara me standardet evropiane apo "Acquis Communautaire" të BE-së - meqë Kosova synon integrimin në Europë. Kemi përshlytjen se deri tani nuk është bërë verifikimi i përputhshmërisë së projektligjeve me "Acquis Communautaire" të BE-së. Pokështu, duket se as Qeveria nuk është duke e bërë gjith-

një një verifikim të këtillë. Si e shihni ju rolin e Kuvendit si "garantues" i harmonizimit të ligjeve të Kosovës me ato të BE-së?

Përkundër faktit se ne e bëjmë kontrollimin e bazueshmërisë së ligjeve të Kosovës me standardet evropiane, mendoj se ende kemi nevojë për asistencë nga ekspertët ndërkombëtarë. Këta ekspertë do ta ndihmonin Komisionin Legjislativ, por edhe Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, rreth vlerësimit të përkimit të këtyre ligjeve dhe akteve të tjera me standardet evropiane, meqë neve ende na nevojiten trajnime dhe udhëzime mbi standardet evropiane në lëmin e ligjvënies. Unë mendoj se nisma që është marrë nga Agjencia Evropiane për Rindërtim është shumë e mirëseardhur, ngase ajo jo vetëm që do t'i ndihmojë Kuvendit të Kosovës për të miratuar ligjet, të cilat do të jenë në përputhshmëri të plotë me ligjet evropiane, por njëherësh edhe do ta përshpejtojnë procesin e integritimit të Kosovës në Evropë.

Kodi Penal dhe Kodi i Proce-

durës Penale janë shpallur. Kuvendi ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në shqyrtimin e tyre. Cilat çështje i konsideroni si më kryesoret në këto ligje. A ka elemente të reja dhe progresive në këto dy ligje?

Mendoj se Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë ligjet më të rëndësishme që i ka miratuar Kuvendi i Kosovës dhe mbase ligjet rreth të cilave vendorët dhe ndërkombëtarët kanë bashkëpunuar më së miri. Gjëja më e rëndësishme rreth këtyre ligjeve është fakti se Kosova për herë të parë ka ligjin e procedurës penale. Në anën tjetër, Kodi Penal është një ligj modern, i xhveshur nga të gjitha elementet ideologjike, që kanë pasur ligjet e mëhershme dhe ligj që pretendon të jetë model i njëmendët për Evropën Juglindore. Shpresoj se me fillimin e vënjes në jetë të tij, do të krijohet edhe baza për funksionimin më të mirë dhe më efikas të gjyqësisë.

Është e ditur se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë po përgatisin propozimet për amendamentimin e Kornizës Kush-



etuese. Komisioni juaj ka formuar një grup punues, ndërsa duket se edhe qeveria po e bën të njejtën gjë. Çfarë është raporti midis iniciativës së Kuvendit dhe asaj të Qeverisë? A është paraparë ndonjë koordinim? Cilat janë pikat kryesore që ka të ngjarë të ndryshohen dhe brenda çfarë afati kohor do të ndodh kjo?

Siç dihet, Kuvendi i Kosovës e ka inicuar ndryshimin e Kornizës Kushtetuese dhe mendoj se kjo nismë është plotësisht legjitime dhe e

bazuar në Kornizën Kushtetuese. Afër mendsh kjo nuk është ndonjë përpjekje për ta sfiduar UNMIK-un apo për t'i marrë njëanshëm kompetencat e UNMIK-ut, por unë do të thoja se kjo është më parë një ofertë shumë serioze e Kuvendit të Kosovës për ta filluar një dialog me UNMIK-un dhe për të krijuar një bazë kushtetuese për bartjen graduale të kompetencave tek institucionet e Kosovës. Në anën tjetër, ndryshimet kushtetuese janë faktikisht

në pajtim me Rezolutën 1244 dhe Kornizën Kushtetuese, të cilat parashohin që populli i Kosovës, në një fazë të mëvonshme, të jetë i aftë dhe i gatshëm për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës. Sa i përket reformës kushtetuese, unë mendoj se ajo pretendon t'i arrijë tri qëllime kryesore. Së pari, të krijojë bazën kushtetuese për bartjen e mëtejshme të përgjegjësisë, jo vetëm të atyre të kreut të pestë, por do të thojë, edhe ato të kreut të tetë, të atyre përgjegjësisë që mund të prejjudikohen, por që nuk prejjudikojnë statusin final. Qëllimi i dytë është që institucioneve të Kosovës t'ua mundësojë të arrijnë një progres në jetësimin e standardeve para statusit. Mendoj se kompetencat e tanishme janë mjaft të kufizuara dhe pengojnë avansimin e proceseve. Prandaj, me marrjen e kompetencave të reja, ne do të jemi të aftë të përsheptomë përmbushjen e standardeve, sidomos tani kur e kemi edhe idenë se si t'i operacionalizojmë standartet. Në këtë mënyrë, edhe përgjegjësia mund të ndahet dhe në njëfarë mënyre do të mund të afatizohen obligimet e Kuvendit dhe Qeverisë për ta shënuar progresin e kërkuar rreth këtyre standardeve.

Përfaqësuesit e UNMIK-ut janë treguar të rezervuar ndaj kësaj nisme. Në lidhje

me këtë, si i shihni zhvillimet në të ardhmen?

Unë mendoj se ngurimet aktuale të UNMIK-ut janë pasojë e faktit se ekziston një drojë që institucionet e Kosovës po përpiqen t'i marrin kompetencat njëanshëm. Unë thashë edhe më parë se për çdo ndryshim në Kornizën Kushtetuese, do të bisedohet me UNMIK-un. Kjo për faktin se është PSSP-ja ai i cili do të vendosë përfundimisht për këto ndryshime, prandaj unë shpresoj se UNMIK-u do të ketë një qasje pragmatike. Sikurse që dihet, UNMIK-u, përveç obligimeve tjera që i ka realizuar, tani është përgjegjës edhe për funksionimin e një qeverisjeje substanciale dhe efektive dhe, do të thojë, lehtësimin dhe përsheptimin e procesit të zgjidhjes finale. Më thotë mendja se këto ndryshime kushtetuese do ta shpiejnë procesin e administrimit ndërkombëtar përpara, në fazën e tretë, dhe unë do të thojë, në fazën përfundimtare. Për këtë arsye, unë mendoj se duhet ta vazhdojmë bashkëpunimin me UNMIK-un dhe do t'u shporremi keqkuptimeve dhe tensioneve, të cilat janë krijtësisht të panevojshme.

Faqja e internetit për Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale është:
www.unmikonline.org/regulations/2003/re2003_25.pdf

Vizitë pune në Holandë

Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje - Perëndim (EWPPP) prej datës 18 deri me 23 tetor 2003 organizoi një vizitë për një delegacion të Kuvendit të Kosovës në Holandë.

Sadik Idrizi, Zëdhënës i grupit parlamentar "Komunitetet tjera"

Kohë më parë një delegacion i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, vizitoi parlamentin dhe qeverinë holandeze, si pjesë e programit të EWPPP-së, "Aspekte dhe Metoda të Demokracisë Parlamentare", e cila e përkrah Kuvendin e Kosovës.

Nikoqir të parlamentarëve të Kosovës ishin si deputetët e tanishëm ashtu edhe deputetët e mëparshëm të Parlamentit dhe të Senatit të Holandës. U mbajtën gjithsej katër mbledhje ku u diskutuan çështjet kryesore që kanë të bëjnë me sistemet parlamentare. Njëherësh u krahasuan sistemet parlamentare të Kosovës dhe Holandës, përfaqësimi i partive të tyre në parlament, transparenca dhe mangësitë parlamentare. Anëtarët e Parlamentit të Kosovës morën pjesë edhe në një sesion të Dhomës së Përfaqësuesve holandez, ku patën rastin të njihen me mënyrën se si funksionon një Parlament me një traditë të gjatë parlamentare. Më pas, i bën një vizitë Senatit të Holandës, dhe me atë rast patën edhe një takim me senatorin Ajmert van Midëllkup dhe me një grup



gazetarësh.

Delegacioni nga Kosova pati edhe një takim me Z. Fransua W. Weisglas, kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve në Parlamentin holandez. Njëkohësisht, delegacioni bëri edhe një vizitë në Ministrinë e Jashtme të Holandës, me ç'rast bisedoi me Z. Jan-Lukas van Hurn, drejtorin e Departementit për Evropën Juglindore dhe Evropën Lindore pranë kësaj ministrie.

EWPPP, institucioni që e organizoi këtë ngjarje, u themelua në vitin 1990 me iniciativën e përbashkët të Fondacionit Evropian për Kulturë dhe Fondacionit Ford. Qëllimi kryesor

i këtij institucioni është që të përkrahë parlamentet e shteteve të reja demokratike në Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe në shtetet e ish Bashkimit Sovjetik. EWPPP harton dhe zbaton programe në bashkëpunim me parlamentet vendore që t'ju ndihmojë parlamenteve për t'i vënë në jetë procedurat organizative dhe çështjet politike në frymën demokratike. Në këtë projekt janë përfshirë mbi njëzet parlamente të vendeve në tranzicion.

Ky program është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës dhe do të vazhdojë deri në vitin 2005.

Të gjithë anëtarët e delegacionit nga Kosova ishin të mendimit se kjo vizitë ishte sa e suksesshme aq edhe e dobishme. Në kuadër të këtij programi është paraparë që në pranverën e vitit 2004, një delegacion i Parlamentit të Holandës ta vizitojë Kosovën. Njëherësh, është parashikur që në vjeshtën e vitit 2004, një delegacion i Kuvendit të Kosovës t'i vizitojë parlamentet e disa vendeve në tranzicion.

Parlamentet: Mbrojtësit e qytetarëve

Prej datës 2 deri me 4 tetor 2003 në Sarajevë u mblodhën parlamentet e Evropës Juglindore për të rrahur çështjet e përbashkëta të zhvillimit dhe mënyrat se si ata si ligjvënës mund të angazhohen në debatet mbi krijimin e politikave. Kjo konferencë rajonale, e cila u organizua nga disa misione dhe institucione të OSBE-së, u përqëndrua në rolin e parlamenteve në mbikëqyrjen e zhvillimeve shoqërore dhe ekonomike si dhe në mënyrat se si mund të mbahet ekzekutivi përgjegjës.

Sven Lindholm, Ushtrues detyre i zëdhënësit të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

“Një parlamentar i zgjedhur në mënyrë demokratike është avokat i qytetarëve dhe shtylla e legjitimitetit, forcës dhe prosperitetit të qeverisë” theksoi ambasadori Robert Beecroft, kryesuesi i Misionit të OSBE-së për Bosnjë dhe Hercegovinë dhe nikoqiri i konferencës.

Në këtë rol, palmentarët njëherësh mund të ndërtojnë kanale komunikimi me qeveri të tjera, jo vetëm për të gjetur zgjidhje për probleme të përbashkëta, por edhe për të luajtur një rol konstruktiv në uljen e tensioneve në rajon.

Zhvillimi Ekonomik / Ulja e Varfërisë

Europa Juglindore është një rajon dinamik me potenciale jashtëzakonisht të mëdha. Rajoni është duke kaluar nëpër një proces të tranzicionit ekonomik, shoqëror dhe institucional. Sipas studimeve të bëra nga Banka Botërore, ky proces ka pasur një ndikim negativ në zhvillimin e rajonit.

“Ajo çfarë kemi të përbashkët janë problemet, konfliktet dhe historia e përbashkët,”

vuri në dukje Natasa Milojevic, deputete e Parlamentit të Republikës së Serbisë, dhe e Komisionit për Uljen e Varfërisë.

“Jemi të shtrënguar, që pak a shumë për shkak të varfërisë, të mbështetemi në shoqi-shoin.”

Përse duhet të angazhohen parlamentet rreth kësaj çështjeje? Derisa ka një zbrastetirë mes asaj çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë mund të bëjnë parlamentet, varfëria mbetet si çështje shoqërore që kërkon zgjidhje. Së këndejmi, kjo çështje nuk është vetëm me interes ekonomik, por edhe shoqëror.

Konferenca e Sarajevës i referua shumë proceseve që po ngjajnë dhe që kanë ndikim për tërë rajonin. Vëmendje të posaçme iu kushtua procesit së strategjisë për pakësimin e varfërisë. Kjo është një qasje multidimensionale ndaj strategjisë së uljes së varfërisë, duke përfshirë pjesëmarrjen e gjerë të parlamenteve, shoqërisë civile dhe sektorin privat si partnerë në zhvillim.

Sërbia dhe Shqipëria tanimë kanë filluar të zhvillojnë

plane afatgjate për t’ju qasur varfërisë. Megjithatë, mbetet si sfidë realizimi i strategjisë, që ka të bëjë me implikacionet e buxhetit.

“Pikë së pari duhet shikuar se si kjo strategji mund të përfshihet në buxhet me qëllim që pastaj të jetësohet” -tha Robert Ceku, parlamentar nga Shqipëria, anëtar i komisionit për Ekonomi, Financa dhe Privatizim. “ne jemi të vetëdijshëm se pa burime të nevojshme financiare strategjia mund të dështoj.”

Një sërë debatesh paralele janë mbajtur mbi marrëdhëniet qeveri-parlament, rolin e parlamentit në mbështetjen e ndërmarrjeve private dhe rolin e tyre në forumin e krijimit të politikave dhe ligjvënies. Punëtoritë dhe debatet kanë dhënë kontributet e ekspertëve për resurset njerëzore, zhvillimin ekonomik dhe uljen e varfërisë.

Perspektiva e Kosovës.

Konferenca Parlamentare ka ofruar një mundësi të veçantë për delegacionin nga Kuvendi i Kosovës që të ta-

kojë - në nivel të barabartë - kolegët nga parlamentet fqinje. Delegacioni shumëpartiak tetë anëtarësh ka qenë i kryesuar nga prof. Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit.

Haki Shatri, kryesues i Komisionit për Buxhet, ka dhënë një kontribut bindës mbi përvojat e Kosovës në tranzicionin ekonomik krahas përpjekjeve për të zhvilluar një sistem të sigurisë shoqërore. Kontributi i tij ka nxitur një debat të gjallë, përveç me parlamentarët e tjerë edhe me ata nga Sërbia.

Delegacioni i Kosovës ka shfrytëzuar këtë rast për të eksploruar çështjet e politikave dhe çështjet praktike të zhvillimit njerëzor dhe ekonomik me të cilat po përballet rajoni.

“Kemi shfrytëzuar kohën për t’u njohur me njëri tjetrin dhe për të krijuar një lloj bashkëpunimi, duke u njohur me problemet sociale dhe ekonomike të njëri tjetrit’ - tha Shatri. Me rastin e kthimit të delegacionit në Kosovë, Shatri ka deklaruar se do ta informojë Kuvendin

për debatet dhe do të propozojë se edhe Kosovës i duhet plani aksional. Ai njëherësh ka shprehur dëshirën që kontaktet e tilla të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Dimensioni Rajonal

Ajo që doli në shesh gjatë diskutimeve është se siguria afatgjate e rajonit dhe zhvillimi janë të lidhura ngushtë. Bashkëpunimi rajonal mund të ndihmojë në kuptimin e politikave sociale dhe ekonomike pasi që çështje të tilla kërkojnë qëndrim të përbashkët.

“Ne duhet të formojmë një rrjet - së pari të palmentarëve dhe autoriteteve qeveritare - meqë përvojat janë të njëjta, por ndryshimet mund të hasen vetëm mes madhësisë së tregut dhe zhvillimit të tregut,” theksoi Natasa Milojevic.

Një pikëpamje e përbashkët e palmentarëve pjesëmarrës ishte nevoja e intensifikimit të bashkëpunimit rajonal përmes informacioneve dhe iniciativave të përbashkëta mbi çështje të këtylla, si bie fjala ekonomia, varfëria,

ulja e varfërisë, ambienti, mbrojtja shëndetsore, energjia elektrike, dhe një sërë çështjesh tjera.

Këtu mund të përfshihen edhe 'mësimet e nxjerra', siç sqaroi Angel Dimitrov, një parlamentar nga ish-republika jugosllave e Maqedonisë, duke thënë se: "Jam i sigurtë që ka dobi nga

bashkëpunimi rajonal ngase përvojat e vendeve që tanimë kanë kaluar nëpër tranzicion janë shumë të dobishme për ne."

Bashkëpunimi rajonal është i pazëvendësueshëm. Parlamentet mund të kanë dobi nga shkëmbimi i përvojave në mënyrë që të hartojnë legjislacion më të mirë dhe

të merren me çështje të përbashkëta shoqërore dhe ekonomike në nivelin rajonal. Të mësojmë nga shoqi-shoi për dobinë tonë.

Perspektiva e OSBE-së

Konferenca e Sarajevës ka njësuar përkushtimet e OSBE-së të dimensionit njerëzor me dimensionin ekonomik

dhe ambiental. Ajo ka ofruar mundësinë e ndihmës për të forcuar mbështetjet institucionale për parlamentet e zgjedhura, duke rritur kapacitetet e tyre për të marrë pjesë në debatet mbi optionet e politikave.

Misioni i OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, Misioni i OSBE-së në Serbi dhe Mal

të Zi, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe prania e OSBE-së në Shqipëri janë duke realizuar projektet për ngritjen e kapaciteteve të parlamenteve.

Këto misione, si dhe "Misioni Spillover" në Shkup, po përgatisin iniciativat pasuese, me mbështetje të përforsuar për punën parlamentare si



dhe inkurajimin e takimeve bilaterale dhe parlamentare në rajon dhe programeve të tjera mbështetëse parlamentare.

Përveç kësaj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR) ka shprehur vullnetin t'ia ofrojë eksperiencën e saj të konsiderueshme parlamentare mbi çështjet e të drejtave të njeriut.

Përfundim

Në fund të Konferencës, ambassadori Pascal Fieschi, Kryesuesi i i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka paraqitur deklaratat e organizatorëve, duke përmbledhur konkluzionet e konferencës.

“Bashkëpunimi rajonal është i mundshëm pasi që Europa Juglindore ka probleme dhe objektiva të përbashkëta” ka thënë ambasadori Fieschi. “Ky forum mund të konsiderohet një hap para në involvimin e mëtutjeshëm të parlamentarëve për t'u ballafaquar dhe për t'i zgjidhur problemet në rajon”

Ekziston shpresa që mesazhet e konferencës do t'i nxisin parlamentet e rajonit të kultivojnë dialogun dhe bashkëpunimin më të përzemërt në mënyrë që të realizojnë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të mbarë rajonit.

Nevoja për konsensus politik në luftimin kundër varfërisë”

Në konferencën e cila u mbajt në Sarajevë prej datës 2 deri me 4 tetor, përveç anëtarëve të Parlamentit të Kosovës morrën pjesë edhe anëtarët e parlamenteve të Shqipërisë, Maqedonisë, Rumunisë, Sllovenisë, Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës.

Zylfije Hundozi, AAK, anëtare e delegacionit në Konferencën e Sarajevës

Të gjitha këto shtete kanë kaluar nëpër periudhën e tranzicionit. Prandaj, ne patëm rastin që të mësojmë më tepër për punën e parlamenteve të këtyre vendeve si në sesionet plenare ashtu edhe në grupet punuese. Për ne ishte sidomos e dobishme që të dëgjojmë se si janë ballafaquar ata me luftën kundër varfërisë si dhe çfarë strategji kanë për uljen e shkallës së varfërisë. Sllovenia e kishte kaluar me sukses periudhën e tranzicionit. Së këndejmi, pas krijimit të shtetit të pavarur, ata ia dolën mbanë që ta zvogëlajnë shkallën e papunësisë dhe ta bëjnë privatizimin.

Gjatë diskutimeve u vu në dukje se Parlamenti duhet të bashkëpunojë sa më mirë me shoqërinë civile në mënyrë që të monitorojë strategjinë politike për zvogëlimin e varfërisë. Parlamenti duhet të ketë kontrollë mbi ekzekutivin për të siguruar zbatimin e një politike që shpie drejt shërbimeve të përmirësuara, të cilat do të mundësojnë zvogëlimin e varfërisë.



Njëherësh, ne patëm rastin që t'i njoftojmë pjesëmarrësit tjerë në aktivitetet e grupeve punuese lidhur me veprimtaritë e përbashkëta të Parlamentit të Kosovës dhe të Qeverisë në luftën kundër varfërisë, duke aplikuar ligje, të cilat do ta përmirësojnë sado pak mirëqenjen shoqërore në Kosovë. Pos kësaj, ne i informuam pjesëmarrësit për vështësitë në të cilat hasim gjatë përgatitjes së strategjive afatgjata për zhvillim ekonomik dhe si-

gurinë, për shkak të moshës së statusit përfundimtar të Kosovës.

Bashkëpunimi rajonal dhe përpjekjet për një integrim më të shpejtë, përpos që e bëjnë të mundur luftimin e varfërisë në mënyrë të vazhdueshme, ato njëherësh lehtësojnë edhe luftën ndaj sfidave të tjera të zhvillimit siç janë: lufta kundër korrupsionit, trafikimit dhe HIV/AIDS.

Diskutimet u zhvilluan në

një atmosferë dhe frymë tolerante. Shumica e përfaqësuesve të parlamenteve ranë dakord se duhet të arrihet një konsensus politik dhe të ekzistojë një plan i përgjithshëm për arritjen e standardeve ndërkombëtare në mënyrë që të fillojë: zbatimi i reformave ekonomike në treg, krijimi i institucioneve demokratike, me politika adekuate monetare dhe fiskale, nxjerrja e ligjeve, të cilat do të mundësojnë tërheqjen e investimeve të huaja si dhe integrimin e mëtutjeshëm të rajonit në strukturat evropatlantike.

Pas diskutimeve të ndërsjellta u konkludua se zhvillimi ekonomik si dhe lufta kundër varfërisë janë të lidhura ngusht me veprimin e shtetit juridik dhe qeverisjen e mirëfilltë.

Konferenca ka qenë e suksesshme dhe së këndejmi, ne i jemi mirënjohës përkushtimit të OSBE-së për ta vazhduar ndihmën rreth bashkëpunimit rajonal dhe forcimit të rolit të parlamenteve.

Zhvillimet e fundit në Kuvend

Gjatë dy muajve të fundit, Kuvendi i Kosovës ka zhvilluar disa debate intenzive, ka marrë vendime dhe iniciativa dhe ka miratuar ligje me rëndësi jetike për shoqërinë e Kosovës. Në vijim, pason një pasqyrë e përgjithshme e rrjedhave të fundit politike në Kuvend, nga mesi i shtatorit deri kah mesi i nëntorit të vitit 2003.

Franklin De Vrieze

Në Kuvend u debatua mbi dialogun Prishtinë - Beograd

Pas Samimit BE - Ballkan në Selanik (qershor 2003), ku u dha pëlqimi për bisedimet e drejtpërdrejta midis Prishtinës dhe Beogradit për çështjet praktike, Përfaqësuesi i ri Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) Harri Holkeri, filloi konsultimet për përgatitjen e takimit që do të mbahej më 14 tetor 2003 në Vjenë. Pjesëmarrja e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-ve) në këtë dialog ishte temë e debateve intenzive për disa javë me radhë.

Që nga muaji gusht, Kryeministri Bajram Rexhepi ka shprehur vazhdimisht pikëpamjen e tij se bisedimet me Beogradin nuk mund të fillojnë pa një vendim nga Kuvendi dhe pa një konsensus mbi fillimin e dialogut. Në të vërtetë, më 15 shtator ai vuri në dukje se "rreziku i vërtetë për dialogun e mundshëm Prishtinë-Beograd nuk vjen nga bisedimet si të tilla, por më parë nga mungesa e unitetit në Kosovë dhe pastaj nga mungesa e një konsensusi të brendshëm mbi çështjen e dialogut."



Prof. Nexhat Daci, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, duke dhënë deklaratën e tij për shtyp, pas përfundimit të sesionit hyrës të dialogut mbi çështjet praktike, që u mbajt në Vienë më 14 tetor 2003. Pranë tij, Dr. Ibrahim Rugova, Kryetar i Kosovës.

Më 2 tetor, Kryeministri u drejtua Kuvendit të Kosovës, duke ritheksuar se qeveria nuk do të marrë pjesë në këto bisedime pa pëlqimin paraprak të Kuvendit. Z. Sabri Hamiti, kryesues i grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), përkujtoi se përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës në të kaluarën kishin përkrahur dialogun me "të gjitha ve-

ndet fqinjë" dhe se Kuvendi nuk kishte kurrfarë arsye për të qenë kundër dialogut. Ai vuri në dukje se disa tema të rendit të ditës për dialog nuk hyjnë në kuadrin e kompetencave të IPVQ-ve. Njëllor, Z. Arsim Bajrami, duke folur në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), shtroi pyetjen nëse ishte koha e duhur për bisedime. Z. Ramush Haradinaj, nga

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), sugjeroi që Kuvendi ta shpallë pavarësinë, në mënyrë që Kosova pastaj të hynte në dialog si e barabartë. Ndryshe nga pikëpamjet e shprehura nga kolegët e tij shqiptarë të Kosovës, Z. Dragisa Krstovic, kryesues i grupit parlamentar "Koalicioni Kthimi" (KP), vuri në pah se negociatat midis IPVQ-ve dhe Unionit Serbi - Mal i Zi,

ofrojnë një shans të vërtetë për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe kushteve të jetës në Kosovë. Z. Sadik Idrizi, duke folur në emër të grupit parlamentar të "Komuniteteve të tjera" (KT-ve), theksoi se grupi i tij do t'i përkrahte pikëpamjet e shumicës lidhur me dialogun, por se dëshironte që fillimisht të sigurohej se edhe KT-të do të përfaqësoheshin si duhet në dialogun eventual. Nga debati nuk doli ndonjë konkluzë.

Më 8 tetor, përfaqësuesit e zyrave të pesë shteteve që përbëjnë "Grupin e Pesëshes" dhe PSSP-ja mbajtën një mbledhje pesë orëshe me Kryetarin Rugova, Kryeministrin Rexhepi, Kryetarin e Kuvendit Daci, Kryetarin e AAK-së Haradinaj dhe Kryetarin e PDK-së Thaçi. Me këtë rast, liderët shqiptarë të Kosovës parashtruan një propozim për bartje të më shumë kompetencave dhe për themelimin e ministrive përkatëse, si parakusht për mbështetjen e dialogut. Megjithatë, nuk u mor asnjë vendim përkritazi me dialogun. Prandaj, presioni diplomatik për ta arritur një pëlqim për pjesëmarrje në dialog sa vinte e shtoj,

duke theksuar para së gjithash nevojën për të biseduar me të gjithë fqinjët si parakusht për integrimin e Kosovës në Evropë. Ndërsa, PSSP-ja paralajmëroi se pajtimi i Kuvendit për dialog me Beogradin nuk do të duhej të konsiderohej domosdoshmëri, Kryeministri Rexhepi (nga PDK-ja), nga ana e tij vazhdoi të bënte thirrje për nevojën e autorizimit nga Kuvendi për pjesëmarrje në dialog. Meqë në rendin e ditës së seancës plenare të Kuvendit të Kosovës që do të mbahej më 9 tetor, nuk ishte përfshirë debati mbi bisedimet Prishtinë-Beograd, kryesuesi i grupit parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, propozoi që debati mbi këtë çështje të shtohej në rendin e ditës. Mirëpo, ky propozim pas votimit u refuzua me shumicë votash, ndërsa Kuvendi vazhdoi me aktivitetet e tij të zakonshme legislative.

Më 10 tetor, Kryetari i Kosovës Ibrahim Rugova iu përgjigj pozitivisht ftesës për të marrë pjesë në bisedime. Sado që u bënë përpjekje të mëdha diplomatike për t'i bindur liderët tjerë kosovarë që edhe ata të merrnin pjesë në bisedime, ato nuk patën sukses. Kështu, delegacioni i Kosovës u nis në bisedime pa ndonjë përfaqësues të qeverisë. Megjithatë, Kryetari Rugova u shoqërua nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Nexhat

Daci, i cili në Vienë shkoi në cilësinë e anëtarit të delegacionit të Kosovës.

Dialogu filloi në Vienë, më 14 tetor, ashtu siç ishte paraparë. Delegacioni dyanëtarësh nga Prishtina ishte numerikisht në përputhje me delegacionin nga Beogradi, i cili përbëhej nga Kryeministri Zhivkoviç dhe zëvendëskryeministri Çoviç. Përderisa, të dyja delegacionet dhanë vlerësime të ndryshme lidhur me situatën në Kosovë, PSSP-ja bëri të ditur se në nëntor duhet të formoheshin grupe punuese që do t'i diskutonin katër pikat e rendit të ditës për bisedime. Pikat e këtij rendi të ditës janë: energjia, transporti dhe komunikacioni, personat e zhdukur, kthimi i PZHV-ve dhe i refugjatëve.

Kuvendi refuzon arrestimin e Komandantit të TMK-së Agim Çeku

Më 22 tetor 2003, policia e Sllovenisë, duke vepruar në bazë të një urdhërarresti ndërkombëtar të lëshuar nga e ashtuquajtura Gjykatë e Qarkut të Prishtinës, me seli në Nish të Serbisë, e arrestoi Komandantin e Trupave Mbrotjtëse të Kosovës (TMK-së), Agim Çekun. Në një bisedë telefonike që PSSP, Holkeri e zhvilloi me Ministrin slloven të Punëve të Jashtme, ai sqaroi se urdhërarresti ishte i paligjshëm, ngase ishte lëshuar

nga një sistem gjyqësor paralel që vepronte ilegalisht, prandaj gjeneral Çeku u lirua në orët e hershme të 23 tetorit.

Po të njëjtën ditë, Kuvendi i Kosovës lëshoi një deklaratë zyrtare e cila u përkrah nga të gjitha palët në Kuvend, përveç nga "Koalicioni Kthimi" (KP-ja) dhe Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK-ja). Në këtë deklaratë, Kuvendi kritikon veprimet e ndërmarrja nga institucionet sllovene me rastin e arrestimit të Çekut dhe hedh poshtë të gjitha urdhërarrestet dhe veprimet e gjykatave që merren nga institucionet serbe dhe institucionet paralele gjyqësore serbe ndaj qytetarëve të Kosovës. Veç kësaj, përmes kësaj deklarate u bëhet thirrje institucioneve ndërkombëtare në Kosovë dhe më gjerë, përfshirë INTERPOL-in dhe EURO-POL-in, që të mos i njohin urdhërarrestet dhe vendimet e tilla. Me anë të kësaj deklarate edhe PSSP-ja ftohet që të ndërmarrë masa urgjente për eliminimin e strukturave paralele në Kosovë. Në diskutimin plenar u përmend edhe raporti i fundit i OSBE-së mbi funksionimin e institucioneve paralele në Kosovë.

Përkrahjet ndryshimi i Kornizës Kushtetuese

Në seancën plenare të Kuvendit, mbajtur më 30 tetor 2003, iu dha drita e gjelbrë

për propozimit për krijimin e një grupi punues të Kuvendit, i cili duhet të ofrojë rekomandime mbi ndryshimet që duhet bërë në Kornizën Kushtetuese. Sponsorët e iniciativës sqaruan se ndryshimet e tilla do të mundësonin bartjen më të shpejtë të kompetencave, përfshirë këtu ato të Kreut 8 të Kornizës Kushtetuese dhe ato që janë të rezervuara për PSSP-në. Kompetencat e reja do t'ua mundësonin institucioneve të përkohshme të arrijnë progres më bindës në përmbushjen e standardeve dhe së këndejmi, t'i ndihmojnë edhe UNMIK-ut që ta përmbushë mandatin e vet. Veç kësaj, diskutimet që do të zhvilloheshin në këtë grup punues do të ndihmonin në përgatitjet për status final. Z. Arsim Bajrami, kryesuesi i Komisionit për Çështje Legjislative, Juridike dhe të Kornizës Kushtetuese, vuri në dukje se "procesi i ndryshimit të Kornizës Kushtetuese është legjitim dhe ofertë shumë konstruktive e institucioneve të Kosovës për UNMIK-un, për ta përmbushur me sukses misionin e tij." Me përjashtim të "Koalicionit Kthimi" (KP), të



Ministresha e Shëndetësisë, Znj. Resmije Mumcu, ia prezanton Kuvendit projektligjin mbi produktet dhe pajisjet mjekësore dhe projektligjin mbi shëndetësinë.

gjitha grupet parlamentare mbështetën këtë iniciativë. UNMIK shprehu rezervat e tij lidhur me këtë iniciativë.

U shqyrtuan dhe u miratuan disa ligje

Gjatë dy muajve të fundit Kuvendi i Kosovës shqyrtoi dhe miratoi disa ligje. Disa nga këto ligje janë aprovuar në shqyrtimin e dytë në datat e poshtëshënuara. Ligjet e poshtëshënuara, të cilat nuk përmbajnë datë, janë aprovuar qysh në shqyrtimin e parë, por që nga mesi i nëntorit janë ende duke u shqyrtuar në komisionet përkatëse të Kuvendit. Këto janë: Ligji mbi sigurinë në punë dhe mbrojtjen shëndetësore për

punëtorë (09.10.2003), Ligji mbi prokurimin publik (11.09.2003), Ligji mbi pensionet për personat e paafte për punë (06.11.2003), Ligji mbi prodhimet dhe pajisjet mjekësore, Ligji mbi inspektionin sanitar (06.11.2003), Ligji që amendamenton ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe kontabilitetin (23.10.2003), Ligji mbi pesticidet (16.10.2003), Ligji mbi shërbimet postare (09.10.2003), Projektligji mbi sportet, Projektligji mbi barazinë gjinore, Projektligji mbi kadastrën, Projektligji kundër diskriminimit dhe Projektligji mbi shëndetësinë.

U shqyrtua Ligji mbi barazinë gjinore

Më 23 tetor 2003, Ligjit mbi barazinë gjinore iu dha përkrahja në shqyrtimin e parë dhe aktualisht është duke u shqyrtuar në disa komisione. Gjatë prezantimit të këtij projektligji, Znj. Melihate Tërmkollli (LDK), kryesuese e Komisionit për Barazi Gjinore, vuri në dukje se ky ishte ligji i parë i inicuar nga strukturat e brendshme të Kuvendit si dhe



Znj. Melihate Tërmkollli, kryesuese e Komisionit për Barazi Gjinore, prezantoi projektligjin që u iniciua nga Kuvendi i Kosovës.

akti i parë legjislativ në Kosovë që merret me çështjet e gjinive. Para parashtrimit të ligjit, shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare dhanë komentet e tyre lidhur me tekstin, duke vënë në pah pjesët, në të cilat përmirësimet nga aspekti ligjor dhe i përmbajtjes do të ishin të mirëseardhura.

Ligjet e miratuara u kundërshtuan nga Koalicioni "Kthimi"

Bazuar në procedurën e përkthuar në Kornizën Kushtetuese, grupi parlamentar "Koalicioni Kthimi" (KP), parashtrori disa mocione, përmes të cilave

kundërshtoheshin ligjet e miratuara, duke theksuar se këto ligje (apo disa dispozita të veçanta të tyre) shkelnin interesat jetike të komunitetit të tyre. Pasi mori përgjigjen nga sponsori i ligjit (qeveria), Kryesia rekomandoi që të formohet një panel i veçantë, ku do të merrnin pjesë përfaqësues nga sponsori i ligjit, pala kundërshtuese dhe UNMIK-u.

Kohët e fundit, KP-ja ka kundërshtuar edhe Ligjin mbi qasjen në dokumentet zyrtare, Ligjin mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, Ligjin mbi prokurimin publik dhe Ligjin mbi shërbimet postare. Në seancën plenare të mbajtur më 16 tetor, Kuvendi miratoi njëherë nga tri rekomandimet e Panelit Special për Ligjin mbi qasjen në dokumentat zyrtare. Kryesia e Kuvendit ka refuzuar mocionin me të cilin kundërshtohesh Ligji mbi shërbimet postare, ngase ky mocion ishte dorëzuar pas afatit të caktuar. Pasi mori përgjigjen nga sponsori i Ligjit (qeveria), Kryesia e Kuvendit refuzoi mocionin ndaj Ligjit mbi prokurimin publik. Mocioni ndaj Ligjit mbi regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është ende në shqyrtim e sipër.

Kryeministri prezanton ligjin kundër diskriminimit

"Ky ligj është në pajtim me ligjet dhe standardet ekzistuese anti-diskriminuese në nivelin Europian dhe ndërkombëtar. Veç kësaj, ligji në fjalë përbushë edhe obligimet që dalin nga Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, ngase është në pajtim të drejtëpërdrejtë dhe të plotë me këto obligime. (...)

Me këtë rast, dëshiroj të theksoj se ligji është i bazuar drejtëpërdrejtë në Direktivën e Këshillit të Unionit Europian 2000/43 që ka të bëjë me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pa dallim përkatësisë racore dhe etnike. Mirëpo, meqë ky ligj nuk është i kufizuar vetëm në diskriminimin mbi baza racore dhe etnike, ai është zgjeruar me ç'rast në të janë përfshirë edhe mbrojtja e kategorive të tjera si fjala vjen të gjinisë, moshës, gjuhës, pikëpamjeve apo bindjeve politike, përkatësisë kombëtare, përkatësisë fetare, njerëzve me aftësi fizike apo mendore, etj, dhe njëherësh ligji i është përshtatur edhe rrethanave dhe kushteve specifike të Kosovës. (...)

Mendoj se ligji e ka edhe rëndësinë e vet politike, ngaqë do ta vendosë Kosovën në ballë të legjislacionit kundër diskriminimit në Ballkan dhe Europë, që do të thotë se me nxjerrjen e Ligjit Kundër Diskriminimit, Kosova qysh në hapat e parë të hartimit të legjislacionit vendor po bën harmonizimin e plotë të legjislacionit të vet me ate Europian."

Dr. Bajram Rexhepi, Kryeministër i Kosovës, në mbledhjen plenare të Kuvendit që u mbajt me 30 tetor 2003.

Kuvendi shqyrton 'Ligjin kundër diskriminimit'

Projektligji kundër diskriminimit, të cilin është duke e shqyrtuar Kuvendi, ka mundësi që ta bëjë Kosovën si vendin me legjislacionin më të avancuar kundër diskriminimit në Ballkan, madje edhe në Evropë. Duke siguruar një instrument ligjor kundër çdo forme të diskriminimit, ky projektligj i plotëson edhe ligjet tjera, siç është ai mbi barazinë gjinore.

Hubert Van Eck Koster, Zyra Këshilldhënëse për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.

Para më shumë se një viti, OSBE-ja ia parashtrroi qeverisë disa ligje, të cilat i shërbyen si modele për hartimin e ligjit kundër diskriminimit. Në Zyrën e Kryeministrit u formua një grup punues, i cili krzesohet nga Arbëresha Shala, zyrtare e Zyrës për Shërbime Ligjore, pranë Zyrës së Kryeministrit. Ky grup punues përfitoi nga modelët e këtyre ligjeve si udhëzues dhe punoi intenzivisht bashkë me ekspertët kosovarë, përfaqësuesit e shoqërisë civile të Kosovës dhe Bashkësinë Ndërkombëtare në hartimin e këtij projektligji, i cili merr parasysh nevojat specifike të Kosovës, si dhe legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe standardet tjera ndërkombëtare, konform me nenin 5.7 të Kornizës Kushtetuese.

Komisioneri evropian Kris Paten, në fjalimin e tij drejtuar Kuvendit të Kosovës më 11 shtator, vuri në dukje se ishte i impresionuar me faktin se Qeveria po hartonte një ligj kundër diskriminimit, të bazuar në standardet evropiane. Ç'është e vërteta, përmes ligjit kundër diskriminimit,



Më 30 tetor, Kryeministri Bajram Rexhepi para deputetëve të Kuvendit prezantoi Ligjin kundër diskriminimit (shih ekstraktet e fjalimit të tij në faqen e mëparshme).

mëtohet të përmushet dhe të zbatohet legjislacioni i Bashkësisë Evropiane, në veçanti Direktiva 2000/-43/EC e Këshillit të BE-së (Udhëzimi mbi barazinë racore), Direktiva 2000/-78/EC e Këshillit të BE-së (që krijon kornizën e për-

gjithshme për trajtim të barabartë në punësim dhe punë) dhe neni 26 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Civile (KNDPC), i cili, sipas nenit 3.3 të Kornizës Kushtetuese, është pjesë e ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

Sipas nenit 26 të KNDPC, ligji kundër diskriminimit e plotëson dhe e shton mundësinë për mbrojtje më efektive kundër diskriminimit në çfarëdo baze të çdo të drejte të mbrojtur me ligj. Ky ligj përfshinë edhe mbrojtjen nga diskriminimi për grupet e cënueshme si fëmijët, të moshuarit, gratë, personat me aftësi të kufizuara mentale dhe fizike, pjesëtarët e komuniteteve etnike, etj.

Së këndejmi, ligji kundër diskriminimit mbron jo vetëm pjesëtarët e komuniteteve etnike, por edhe të gjitha grupet e cënueshme. Për më tepër, ky projektligj siguron që gjyqësori ta përdorë ligjin, i cili viktimës së diskriminuar i ofron mbrojtje më të madhe. Ndërsa ligji kundër diskriminimit, ofron një instrument ligjor kundër çdo forme të diskriminimit që mund të paraqitet, ligjet tjera do të nevojiten për parandalimin e formave të caktuara të diskriminimit. Fjala vjen, ligji mbi barazinë gjinore, që parandalon diskriminimin e bazuar në gjini, apo ndonjë ligj tjetër që parandalon diskriminimin ndaj

personave me aftësi të kufizuara.

Pra, Ligji kundër diskriminimit, Ligji mbi barazinë gjinore dhe ligjet tjera që mbrojnë grupet e cënueshme, plotësojnë njëri tjetrin duke ofruar qoftë instrumente ligjore, kur bëhet ndonjë diskriminim, qoftë masa për parandalimin paraprak të diskriminimit.

Më 17 shtator, qeveria aprovoi Ligjin kundër diskriminimit. Më 26 shtator ky projektligj iu dorëzua Sekretariatit të Kuvendit dhe më 30 tetor ai hyri në agjendën e Kuvendit për shqyrtim të parë. Kështu, pas fjalës hyrëse mjaft impresionuese të Kryeministrit dhe pas një debati intenziv, gjatë të cilit u shkëmbyen akuza mbi diskriminimin etnik, si nga deputetët kosovarë shqiptarë të Kuvendit kundër deputetëve serbë të Kuvendit, ashtu edhe anasjelltas, të gjitha grupet politike votuan pro ligjit kundër diskriminimit, me përjashtim të koalicionit "Kthimi". Sipas deputetit Ivanoviq, koalicioni "Kthimi" në parim do ta mbështeste këtë ligj, po të

mos ishte teksti i shkruar aq dobët. Edhe pse ende nuk është konfirmuar, por mbështetur në disa shqetësime të cilat u ngritën nga lideri i këtij grupi parlamentar Dragisha Kërstoviq, ka të ngjarë se koalicionit "Kthimi" i është dorëzuar një version i përkthyer dobët i ligjit kundër diskriminimit.

Kundërthëniet kryesore që u paraqitën gjatë diskutimit kishin të bënin me disa dispozita paravajtëse të projektligjit e në lidhje me një veprim konkret - themelimin e një qendre për trajtim të barabartë - dhe me një dispozitë që do ta promovonte dialogun social midis punonjësve dhe punëdhënësve. Megjithatë, të gjitha këto dispozita janë marrë drejtpërsëdrejti nga Direktiva 2000/43/EC e Këshillit të Evropës. Shpresojmë se këto kundërthënie nuk do të paraqesin pengesë për miratimin e ligjit kundër diskriminimit në Kuvend, ngase nëse nxjerret ky ligj, Kosovën do ta vëjë në ballë të legjislacionit kundër diskriminimit në Ballkan, madje edhe në Evropë, meqë Kosova do të jetë vendi i parë që do të kishte një ligj aq gjithëpërfshirës kundër diskriminimit. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm drejt aspiratave të Kosovës për integrim në Evropë.

Kuvendi i Kosovës dhe vendim-marrja politike

Prof. Dr. Svetomir Samardzic, Koalicioni Kthimi

Gjatë muajve të fundit në Kuvend ka pasur mjaft konflikte ndër-partiake. Arsyeja kryesore për këto konflikte është atmosfera e trashëguar e pasluftës, e cila nuk mund të tejkalohet aq lehtë, por edhe atmosfera e krijuar me rastin e fillimit të bisedimeve në Vjenë. Qëndrimet e ndryshme të partive politike përkthimi me dialogun dhe disiplinën partiake po e pengojnë lirinë edhe ashtu të kufizuar të shprehjes të shumicës së deputetëve të Kuvendit. Si rrjedhojë, kemi një përparim të ngadalshëm të proceseve demokratike. Prandaj, është me rëndësi që të kuptohet se demokracia nuk arrihet edhe aq lehtë dhe se nuk mund të importohet nga jashtë.

Në duhet t'i qasemi demokracisë në mënyrë të drejtë dhe të luftojmë për te me të gjitha mjetet demokratike. Në këtë situatë me rëndësi politike për Kosovën, përgjegjësia më e madhe bie mbi partitë politike që janë të përfaqësuara në Kuvend. Megjithatë, përgjegjësia bie njëkohësisht edhe mbi bashkësinë ndërkombëtare e cila ka marrë përsipër rolin mjaft të vështirë të qeverisjes së për-



kohshme të Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare nuk duhet ta kufizojë angazhimin e saj vetëm rreth monitorimit, por duhet të jetë një faktor relevant në procesin e pajtimit dhe të demokratizimit.

Këto ditë ka ndodhë një rast mjaft i pazakonshëm në jetën parlamentare të Kosovës. Kështu, propozimi im për amendamentimin e Ligjit mbi Inspeksionin Sanitar si anëtar i Komisionit

për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, ndonëse në kundërshtim me pikëpamjet e shprehura më herët nga të tri komisionet e Kuvendit, u miratua me vendimin e shumicës. Kjo nxiti ndjenja ambivalente në mua: nga njëra anë, unë jam i kënaqur që ia kam dalë mbanë ta kandis shumicën në Kuvend se miratimi i ligjit është në interesin e qytetarëve të Kosovës. Nga ana tjetër, refuzimet e shpeshta të

amandamenteve të dobishme vetëm për shkak se ato poropozohen nga grupet e opozitës, nxit ndjenjën e letargjisë dhe të depresionit. Në duhet të tregohemi më tolerant së paku në fushat që kanë të bëjnë me jetën e përditshme të qytetarëve dhe që të dy palët të tregojmë më tepër mirëkuptim politik. Prandaj, miratimi i amandamenteve është vetëm hapi i parë, po shumë i rëndësishëm në këtë drejtim të krijimit të marrëdhënieve tolerante në mes të njerëzve të cilët vendosin për këto çështje të cilat kanë rëndësi jetësore për qytetarët.

Vendim-marrja politike duhet ta ketë pikëmbështetje në fuqinë e argumenteve, përmes të cilave edhe dispozitat e ndryshme duhet të dëgjohen apo analizohen, dhe të miratohen apo hedhen poshtë, varësisht nga interesat tona. Izolimi, joutoleranca, fyerjet në baza individuale dhe kombëtare nuk do të sjellin ndonjë të mirë për askënd. Nderi dhe reputacioni i kundërshtarëve politikë nuk duhet të nëpërkëmbet. Një veprim i tillë patjetër se do të kthehet si bumerang.

Kontrollimi dhe balancimi i buxhetit të Kosovës

Qeveria e Kosovës është duke përfunduar përgatitjen e buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2004. Ndërsa pritet që Kuvendi ta rishqyrtojë buxhetin, porcesit të komplikuar të përgatitjes së buxhetit po i afrohet fundi. (Një vështrim).

Stefën Lids, Këshilltar për buxhet në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Nuk është habi që e vetmja formë e qeverisjes së Kosovës kohëve të fundit ka rezultuar në krijimin e një procesi unik të përgatitjes së buxhetit në Kosovë. Sipas Kornizës Kushtetuese, Ligjit për menaxhim e financave publike dhe rregullores për buxhetim vjetor, PSSP-ja, IPVQ-të dhe Kuvendi i Kosovës, kanë role dhe përgjegjësi të caktuara sa i përket procesit të buxhetimit. Përveç kësaj, edhe organizatat ndërkombëtare dhe donatorët kanë rolet e tyre, të cilët padyshim se mund të ndikojnë në procesin e buxhetimit.

Buxheti i Kosovës grumbullon fondet nga të ardhurat, nga taksat, pagesat administrative (veçanërisht në nivelin lokal) dhe donatorët. Fondet e donatorëve mund të jenë të destinuara për aktivitete specifike apo mund të jenë edhe "të padestinuara", pra derdhen në buxhet për përdorim të përgjithshëm.

Procesi i buxhetimit në Kosovë menaxhohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF-i) që përbëhet

nga stafi kosovar dhe këshilltarët ndërkombëtarë. Njësitë kryesore organizative kanë role të ndryshme gjatë procesit të buxhetimit. Zyra e ministrit udhëheq procesin e përcaktimit të politikave dhe prioritetëve dhe bashkëpunon në rrafshin politik me PSSP-në, Këshillin Ekonomik e Fiskal (KEF), ministritë e tjera, Kuvendin dhe komunat. Departamenti Qendror i Buxhetit drejton proceset e përditshme të formulimit dhe prezentimit të buxhetit të Kosovës dhe bashkëpunon në nivelin operacional me KEF-in, ministritë tjera si dhe Kuvendin. Departamenti Komunal i Buxhetit që drejton punën e përditshme të formulimit të buxhetit të Kosovës dhe bashkëpunon në nivelin operativ me komunat. Departamenti i Thesarit mbikqyrë informatat rreth realizimit të buxhetit të Kosovës nëpërmjet sistemit "Freebalance" dhe u ofron informata të nevojshme Departamentit Qendror të Buxhetit dhe Departamentit Komunal të Buxhetit. Departamenti Makro-Ekonomik kujdeset për

përgatitjen e llogaritjeve të të ardhurave dhe informatave përcjellëse, të cilat janë të nevojshme për formulimin, prezentimin dhe zbatimin e buxhetit të Kosovës. Departamenti për Koordinimin e Donatorëve mbështet proceset e bisedimeve me organizatat donatore dhe të sigurimit të fondeve për buxhetin e Kosovës, përfshirë përcjelljen e faturimit dhe shpenzimit të këtyre fondeve.

MEF-i bazohet në modelin dhe kalendarin që vlen edhe për të gjitha qeveritë tjera me rastin e përgatitjes së buxhetit, por me disa dallime. Në përgjithësi, PSSP-ja ka autoritetin final vendimmarës mbi buxhetin e Kosovës. PSSP-ja mund të pranojë rekomandime për buxhet nga MEF-i dhe KEF-i. Por, ai mund edhe t'i refuzojë këto rekomandime si dhe mund të marrë hapa unilateralë sa i takon vendimeve rreth buxhetit. Si rrjedhojë, këto rekomandime si dhe mund të marrë hapa unilateralë sa i takon vendimeve rreth buxhetit. Si rrjedhojë, këto rekomandime si dhe mund të marrë hapa unilateralë sa i takon vendimeve rreth buxhetit. Si rrjedhojë, këto rekomandime si dhe mund të marrë hapa unilateralë sa i takon vendimeve rreth buxhetit.

në ndarjen e fondeve për veprimtari të ndryshme në qeveri. Sikurse edhe në qeveritë e vendeve që janë në tranzicion, edhe tek ne roli dhe statusi i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore (siç është rasti me KEK-un dhe disa ndërmarrje të tjerat) është ende i paqartë. Nga njëra anë, ato dëshirojnë të marrin fonde nga buxheti qëndror, por nga ana tjetër, ato nuk i nënshtrohen kontrollimit gjatë procesit të buxhetimit, në të njëjtën mënyrë si agjencitë qeveritare "tradicionale". Meqë procesi i buxhetimit në Kosovë është i ri dhe për shkak se Ligji mbi menaxhimin e financave publike është miratuar në maj të vitit 2003, procesi i buxhetimit është ende në fazën e formimit. Kjo do të thotë se edhe pse tanimë përgjegjësitë dhe datat për veprime specifike dihen, procesi i buxhetimit nuk është ende plotësisht në pajtim me praktikat ndërkombëtare. Para së gjithash, për shkak të numrit të madh dhe kompleks të organizatave dhe individëve të angazhuar në procesin e përgjithshëm

vendim-marrës, afatet kohore që janë të caktuara me Ligj dhe që janë të nevojshme për formulimin me kohë të buxhetit nganjëherë nuk përmbushen. Si pasojë e kësaj, në fund të vitit duhet të merren tepër shumë vendime ashtu që buxheti të realizohet para 31 dhjetorit.

Në Kosovë ka tepërcë në buxhet për shkak të dy faktorëve. Agjencitë shpenzuese dhe menaxherët e stafi i tyre, janë shpesh-herë fillestarë në punët që bëjnë, dhe meqë agjencitë shpenzuese nuk kanë përvojë të mjaftueshme si organizata qeveritare, ato nuk janë në gjendje që t'i kryejnë tërësisht të gjitha funksionet për të cilat janë përgjegjëse. Në disa raste, agjencitë shpenzuese mbivlersojnë shpenzimet e parashikuara, ngase qeveria e Kosovës në përgjithësi akoma s'ia ka daluar mbanë që t'i përcaktojë "kostot standarde" mallra dhe shërbime të posaçme për qeverinë apo të veçanta për secilën agjenci shpenzuese.

Ka të ngjarë që tepërcat buxhetore të ketë edhe për disa vite, derisa agjencitë shpenzuese të arrijnë shka-

llën gjegjëse të efikasitetit operacional. Por derisa të ketë teprica, ato mund të përdoren për projekte kapitale të një-hershme, për raste emergjente, për format të tjera të shpenzimit që nuk pritet të paraqiten përsëri. Megjithatë, duhet të përdoret me mençuri sepse një proces i shëndoshë i buxhetimit bazohet në konceptin e shpenzimit vetëm të parave të ndara vit për vit.

Sipas projekteve makro-ekonomike dhe bazuar në ligjet e tashme për mbledhjen e tatimeve, përlogarive të të ardhurave dhe fondeve që sigurohen nga donatorët, burimet e përgjithshme të Kosovës po i afrohen maksimumit, që do të thotë se nuk pritet që Kosova të ketë rritje të përhershme të buxhetit, që do të jetë në dispozicion të qeverisë së saj, përveç nëse do të ketë rritje ekonomike, ose nëse do të ndryshohet ligji mbi taksat.

Por, nevojat e qeverisë për t'i përmbushur kërkesat janë në rritje për shkak të shtimit të programeve të reja, planeve pensionale dhe vepërimitarive të ngjashme.

Duhet pasur kujdes që të garantohet ekzistimi i balancit të duhur në mes të të ardhurave dhe shpenzimeve pasi Korniza Kushtetuese ndalon akumulimin e deficitit në buxhet.

Këmbimi i informatave: Çelësi i qeverisjes së sukseshme

Rainer Willert, Kryesues i Zyrës Rajonale, Fondacioni Fridrih Nauman

Tashmë ekziston një traditë e bashkëpunimit midis tri komisioneve të rëndësishme të Kuvendit të Kosovës - Komisionit për Financa dhe Ekonomit, Komisionit për Tregti dhe Industri dhe Komisionit për Buxhet - me Fondacionin Friedrich Naumann. Na kujtohet shumë mirë takimi i parë, që u mbajt në shtator të vitit 2002, kur Z. Klaus Bynger, ish-sekretar shteti në Ministrinë për Ekonomi të Gjermanisë, foli për ekonominë sociale të tregut. Me këtë rast, Z. Bynger parashtrij një shembull nga historia gjermane që kishte të bënte me vështirësitë që paraqiten në bashkëqeverisje. Gjatë pushtetit të Aleancës mbi Gjermaninë Perendimore pas Luftës së Dytë Botërore, Z. Ludwig Erhard ka pasur përgjegjësi të kufizuara si ministër i ekonomisë. Në qershor të vitit 1948 ai ishte kritikuar ashpër nga komandanti suprem i forcave të Aleancës, gjenerali Klej, për ndryshimin e njëanshëm të rregullave të përcaktuara mbi tregjet dhe çmimet.

Edhe pse situata e atëhershme në Gjermani nuk mund të krahasohet drejtpërdrejt me situatën e tanishme në Kosovë, Gjermania në atë kohë ka pasur sovranitet të kufizuar. Ishte e qartë se Z. Bynger e zgjodhi këtë shembull për diskutim në ligjëratën e tij, për të bërë një krahasim

midis specifikave të situatës në Gjermaninë e pasluftës dhe realitetit të tanishëm të "pushtetit të rezervuar" në Kosovë. Në rrethana të tilla, mendimet dhe idetë për trajtimin e çështjeve dëndur ndryshojnë dhe prandaj ato lehtë mund të shkaktojnë konflikte, siç u pa edhe nga shembulli i paraqitur nga Z. Klej dhe Z. Erhard.

Me të vërtetë është e udhës që të përmirësohet qarkullimi i informatave të përbashkëta midis "akterëve" të ndryshëm, sepse kjo, në radhë të parë, shmang konfliktet. Fondacioni Fridrih Naumann konsideron se ende ekziston një nevojë e madhe për këmbim të informatave, veçanërisht midis Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV-Q-së) dhe institucioneve homologe ndërkombëtare, nga një anë por edhe midis vetë IPVQ-ve, respektivisht Qeverisë dhe Kuvendit, nga ana tjetër.

Strukturat relativisht të ndërlukuara të bashkëqeverisjes në Kosovë midis forcave vendore dhe ndërkombëtare e bëjnë edhe më të rëndësishëm informimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e rregullt të informatave. Kjo nevojë e veçantë për këmbim të informatave mplekset me një fakt tjetër shumë të qartë, respektivisht shtimin e vazhdueshëm të paqartësive të

reja si rrjedhojë e procesit të vazhdueshëm të bartjes së kompetencave nga UNMIK-u tek IPVQ-së. Me këtë rast, nuk duhet harruar ndërlikimet strukturore dhe dallimet në njohuritë praktike që ekzistojnë në fillim të procesit të transformimit në Kosovë. Këto njohuri janë shtuar dukshëm përmes "punës konkrete", trajnimeve dhe konsultimeve, duke kompensuar kështu pjesërisht materialin dhe pajisjet shumë të kufizuara në IPVQ.

Në ndërkohë, Fondacioni Fridrih Naumann, me ndihmën e OSBE-së, ka organizuar katër takime konsultative. Në këto takime u ftuan edhe ministrat e qeverisë si dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut. Në njërin nga këto ngjarje, disa nga "konsultatorët" e legjislacionit, siç janë sipërmarrësit e ndryshëm, diskutuan me deputetët e Kuvendit lidhur me mënyrën se si iniciativat e reja të ligjvënies gjykohen nga qarqet e biznesit në Kosovë. Në njërin nga takimet e kohëve të fundit, i cili u mbajt në mes të muajit shtator 2003, kishte për synim marrjen e informatave më të reja nga "Shtylla IV", institucioni i UNMIK-ut përgjegjës për çështjet e ekonomisë. Kurreshtja e deputetëve të Kuvendit u shtua kur Andreas Vitkovski, këshilltar në Shtyllën



IV, tha se së shpejti do të filloje formulimi i strategjisë së re për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Shumica e anëtarëve të pranishëm të komisioneve ishin të mendimit se ata patjetër duhet marrin pjesë në një debat të tillë.

A duhet ata me të vërtetë të jenë pjesë e këtij debati? Me gjasë, nuk ekziston ndonjë rregull e qartë mbi këtë. Thënë më saktë, për shkak të ekzistimit të një lloji të tillë të strukturave "të hapura" dhe nganjëherë edhe të mungesës së rregullave apo së pa-ku rregullave të paqarta në Kosovë, duket se nevojitet një dialog i ngjeshur midis UNMIK-ut dhe IPVQ-ve. Fondacioni Fridrih Nauman mundëson dhe lehtëson mbajtjen e debateve të tilla. Ne jemi të sigurtë se ky lehtësim është një instrument me rëndësi, i cili mundëson përmirësimin e strukturave të papërshtatshme, të cilat, pa dyshim, janë veçori e çdo tranzicioni.

Vlerësimi i punës së zyrës ligjore të Kuvendit të Kosovës

Drejtori i Departamentit Ligjor, Z. Daut Beqiri i shfaq mendimet e tij lidhur me punën e këtij Departamenti. Me këtë rast, ai foli për të arriturat e këtij departamenti, por njëkohësisht vuri në dukje se ka ende hapësirë për përmirësime, në mënyrë që Kuvendit të Kosovës t'i ofrohen shërbime sa më të mira.

Intervistën e zhvilluan Edi Efendia (NDI) dhe Dardan Velija (OSBE)

-Si e vlerësoni punën e zyrës suaj, dy vite pas themelimit të saj?

Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale është përgjegjës për të ofruar mbështetje ligjore dhe procedurale deputetëve, komisioneve parlamentare, grupeve parlamentare dhe Kryesisë së Kuvendit.

Angazhimi i stafit të këtij Departamenti është në nivelin e kënaqshëm por ende jo në atë të dëshiruar. Tani për tani, kemi mjaft punë si në Zyrën për parashpresa dhe propozime ashtu edhe në Zyrën e komisioneve. Kështu, gjatë javës stafi ofron shërbime për tri deri katër komisione parlamentare dhe përcjellë gjashtë deri tetë mbledhje të komisioneve. Për çdo mbledhje duhet bërë punët paraprake, siç janë hartimi i procesverbalit dhe përgatitja e raportit me rekomandime për Kryesinë dhe për Kuvendin. Prandaj, për të shtuar efikasitetin dhe cilësinë e punës, është i domosdoshëm shtimi i numrit të zyrtarëve ligjor në këtë Departament.

-Si e vlerësoni bashkëpunimin në mes të departamenteve ligjore të IPVQ-ve dhe të UNMIK-ut

Pa pretendime për vlerësimin e bashkëpunimit të zyrave ligjore të IPVQ-ve tjera dhe asaj të UNMIK-ut, unë konsideroj se ai duhet të bazohet në kriteret, kushtet dhe procedurat e parapara me udhëziminim administrativ për hartimin dhe procedimin e projektligjeve. Sipas këtij udhëzimi, këto zyre ligjore, në faza të caktuara u nënshtrohen detyrimeve të njoftimit dhe harmonizimit të shumë çështjeve ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat.

Bashkëpunimi i Zyrës ligjore të Kuvendit me atë të UNMIK-ut, është i kënaqshëm. Kjo duket sheshit më së miri gjatë bashkëpunimit rreth çështjeve juridike dhe procedurale, të rregullave dhe të procedurave si dhe në fazën e shqyrtimit të projektligjeve në komisionet parlamentare. Unë mendoj se Zyra ligjore e UNMIK-ut, mund të kontribuojë më tepër në



fazën e hartimit të projektligjit se sa në fazën e shqyrtimit të tij në Kuvend.

-Cilat janë prioritetet rreth nevojave të trajnimit të stafit?

Perfeksionimi i stafit është preokupimi im i përherëshëm. Trajnimi duhet kuptuar si aftësim të stafit për të zotëruar me rregullat e procedurave në të gjitha fazat e punës që nga Zyra për propozime dhe parashpresa, e deri në punën e komisioneve parlamentare dhe të seancave plenare. Së këndejmi, trajnimi i stafit duhet të behet konform dispozitave të Rregullores

së punës së Kuvendit të Kosovës. Megjithatë, ne duhet të mësojmë më tepër nga përvoja e shteteve që kanë sisteme të ngjashme parlamentare me sistemin parlamentar në Kosovë, ngase një përvojë e tillë është jashtëzakonisht e dobishme.

-Si i vlerësoni iniciativat e kohëve të fundit ku komisionet parlamentare i përgatisin vetë projektligjet, siç ishte rasti me Ligjin për Barazi Gjinore?

Edhe sipas Kornizës Kushtetuese por edhe në bazë të Rregullores së punës, komisionet parlamentare, mund të përgatisin dhe t'i parashtrajnë projektligje Kuvendit. Projektligji i parë i draftuar nga Komisioni për Barazi Gjinore, tanimë e ka kaluar fazën e miratimit në parim dhe së shpejti pritet shqyrtimi i dytë dhe miratimi i tij. Këtë të drejtë kanë filluar ta shfrytëzojnë edhe komisionet tjera. Kjo është një e arritur që duhet përkrahur. Për më tepër, kësaj rruge është nisur edhe Komisioni për Tregti dhe

Industri, i cili ka miratuar propozimin për fillimin e hartimit të projektligjit për energjetikë. Mendoj se kjo praktikë duhet vazhduar, krahas aftësimin të zyrtarëve të komisioneve si dhe angazhimit të ekspertëve të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

-A planifikoni të punësoni përkthyes për anglisht-shqip/serbisht në zyrën ligjore në mënyrë që të komunikoni më lehtë me zyrtarët e UNMIK-ut?

Komunikimi gojor dhe me shkrim në të tri gjuhët, jo vetëm me UNMIK-un por edhe me të tjerët, është shumë i rëndësishëm. Me 15 shtator 2003, ka filluar realizimi i projektit të AER-it për përkrahje Kuvendit në fushën legjislativë. Me këtë projekt parashihet punësimi i dy përkthyesve për shqip, serbisht dhe anglisht.

-Ju jeni anëtar i Bordit të sapa-themeluar të projektit të fjalorit tregjuhësh të termave parlamentarë dhe ligjor. Si mendoni të kontriboni ju dhe Departamenti Ligjor?

Projekti për hartimin e fjalorit të termave parlamentare-juridike, i mbështetur nga OSBE-Departamenti për demokratizim, më në fund filloi të realizohet. Unë jam anëtar i Bordit të projektit. Por, unë njëkohësisht do të kontribuoj edhe si njohës i terminologjisë parlamentare dhe juridike që ky fjalorth të jetë me një cilësie sa më të lartë.

-Në një mbledhje pune të mbajtur nga FNS për stafin ligjor, ju keni deklaruar se Departamenti po përballlet me rritjen e vëllimit të punës për shkak të shtimit të punës rreth procesit legjislativ. Si i planifikoni punët e stafit tuaj me komisionet? A keni mungesë kuadrosh? Çfarë mendoni të ndërmerrni në këtë drejtim?

Është fakt i pamohueshëm se ekziston një rritje e intensitetit të punës në procesin legjislativ të Kuvendit. Gati çdo javë, Kuvendi shqyrton së paku një ligj në parim dhe miraton një ligj. Prandaj, kjo tempo e shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve kërkon edhe angazhim maksimal të stafit që punon në zyret ligjore gjatë punës së tyre me komisione. Deri më tani, Kuvendi ka themeluar 19

komisione parlamentare. Punët mbështetëse dhe administrative - profesionale për këto komisione i kryejnë vetëm pesë ekipe të stafit. Së shpejti, pritet krijimi edhe i një ekipi të zyrtarëve, i cili do të punojë me komisione.

-Z.Beqiri, Ju e dini se ASI është formuar për të mbështetur punën e Kuvendit në përgjithsi. Sipas mendimit tuaj, çfarë mund të bëjë ASI në të ardhmen për të ndihmuar tejkalimin e vështirësive me të cilat ndesheni gjatë punës suaj?

Kontributi i ASI-it për mbështetjen e punës së Kuvendit, është vërtet i madh dhe i pakontestueshëm. Kjo konsiston në ofrimin e ndihmës së madhe në fushën e informimit për të gjitha rrjedhat, të arriturat dhe veprimet tjera në Kuvend. Ma ha mendja se kontributi i ASI-t edhe në të ardhmën është më se i nevojshëm për projektet siç janë shtypja e Rregullores së punës. Gjithashtu, do të ishin të mirëseardhura projekte për stërvitjen e stafit, duke pasur parasysh nevojat e veçanta. Në këtë aspekt, çdo projekt lidhur me aplikimin e Rregullores së re të punës do të ishte i mirëseardhur.



Pamje nga seancat e fundit plenare të Kuvendit.

Aktivite për mbështetje Kuvendit

Friedrich Naumann Stiftung (FNSt) organizon vizitë për komisionet e Kuvendit në Austri

Përpos ofrimit të mbështetjes këshilldhënëse deputetëve të Kuvendit, Fridrih Nauman Stiftung organizoi edhe një vizitë në Austri për kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisionit për Buxhet, komisionit për Tregti dhe Industri dhe komisionit për Financa dhe Ekonomi. Qëllimi i kësaj vizite, e cila do të zhvillohet prej datës 9 deri me 13 dhjetor, është që t'ju bëhet e mundur parlamentarëve shkëmbimi i përvojave me kolegët e tyre nga parlamanti i Austrisë. Veç kësaj, janë planifikuar edhe vizita në institucionet ekonomike dhe takime me investitorët potencialë.

Takim pune i mbajtur nga Z. Majkëll Xhorxh Link - FNSt, për stafin ligjor të Kuvendit

Më 30 shtator, Majkëll Llink, këshilltar i Fondacionit gjerman Fridrih Nauman mbajti një takim pune me stafin ligjor të Kuvendit të Kosovës. Ky takim u organizua në bashkëpunim me ekipin për mbështetje Kuvendit Qendror të OSBE-së. Në debatet e këtij takimi u trajtuan metodat e shtimit të efikasitetit të punës brenda departamentit ligjor të Kuvendit, siç janë mënyrat praktike të përfshirjes së amandamenteve në projektligje. Përveç këshillave praktike të ofruara nga kolegu i tyre gjerman, stafi ligjor shfaqti interesim të madh edhe për procesin e legjislacionit evropian. Në kuadrin e përpjekjeve për përshtatjen e legjislacionit të Kosovës me atë të UE-së Aquis Communautaire, FNSt-ja planifikon që në të ardhmen të ofrojë konsulta të hollësishme për stafin ligjor.

Vizitë e Divizionit për Media të Kuvendit në Slloveni

Ekipet për mbështetje qeverisjes qendrore dhe ai për media të OSBE-së organizuan një vizitë për anëtarët e Divizioni për Media i Kuvendit të Kosovës në Slloveni. Ky projekt ua bëri të mundur përfaqësuesve të Kosovës që të takohen me homologët e tyre nga parlamenti Slloven, me ç'rast ata patën rastin të zhvillojnë biseda me zëvendës kryesuesin e Njësisë për informim të Kuvendit Kombëtar të Sllovenisë, redaktorin e Buletinit të Kuvendit "Porocevalec" (Informatori) dhe me Kryesuesin e Njësisë për informim në qeverinë e Sllovenisë. Njëherësh, delegacioni nga Kosova shfrytëzoi rastin për t'u njohur më për së afërmi me mënyrat e komunikimit të Divizioni për Media i Kuvendit të Sllovenisë me publikun, me mjetet me anë të të cilave agjensitë qeveritare realizojnë bashkëpunimin e tyre dhe me qasjet e përcaktuara nga Kuvendi për të promovuar punën e tij në opinionin e gjerë publik, ku përfshihen gazetatat informative, interneti (web-faqja e Kuvendit) dhe mekanizmat e rrjetave rajonale për të promovuar Slloveninë jashtë vendit.



Projekti për mediat: Trajnimi i gazetarëve, të cilët përcjellin aktivitetet e Kuvendit dhe përgatisin emisione televizive rreth veprimtarisë së Kuvendit të Kosovës, 29 shtator - 3 tetor

Faza e parë e programit për media, që u mbajt nën përkujdesjen e Ekipit për përkrahje qeverisjes qendrore dhe Ekipit për media të OSBE-së, kishte për qëllim trajnimin e gazetarëve, të cilët i mbulojnë aktivitetet e Kuvendit, dhe raportojnë rreth temave politike. Rezultatet e këtij projekti janë një seri programesh televizive 30 minutëshe, që transmetohen një herë në muaj (në tetor, nëntor dhe dhjetor). Falë sukseseve të arritura gjatë fazës së parë të projektit, tanimë dihet se do të ketë edhe projekte të tjera për vitin 2004.

Projekti ka për qëllim që t'i zhvillojë shkathtësitë hulumtuuese dhe hetuese të gazetarëve kosovarë gjatë raportimit mbi temat politike dhe t'ua mundësojë atyre që të mësojnë më tepër mbi mënyrat e përgatitjes së emisioneve televizive, të cilat pasqyrojnë me përpikëri dialogun dhe zhvillimet politike, dhe në të njejtën kohë informojnë publikun. Me rekomandimin e ekspertit slloven, i cili e mbajti trajnimin në Kosovë, në fazën e dytë të këtij projekti do të përfshihet edhe vizita e katër gazetarëve kosovarë në Slloveni nën drejtimin e kryeredaktorit. Pas trajnimit intensiv dhe bashëveprimimit me homologët e tyre nga Sllovenia, eksperti slloven në dhjetor do të kthehet në Kosovë për të mbajtur pjesën e fundit të këtij trajnimi.

Trajnimi i NDI-së mbi marrëdhëniet me zgjedhësit gjatë muajit tetor

Në muajin tetor, NDI ka parashikuar mbajtjen e trajnimeve mbi marrëdhëniet me zgjedhësit në 5 rajone të Kosovës. Fjala është për trajnim e këshilltarëve komunal, ndërsa trajnimet do të përqëndrohen rreth një mori çështjesh siç janë funksionimi i kuvendeve komunale, menaxhimi

i buxhetit, mbikëqyrja e ekzekutivit si dhe çështje të tjera. Një pjesë e trajnimit është mbajtur me një audiencë të përzier, ku përpos këshilltarëve komunal kishte edhe përfaqësues të OJQ-ve dhe partive politike. Qëllimi kryesor ishte që të nxitej një koordinim më i mirë në mes të gjithë akterëve, në mënyrë që të përmirësohen marrëdhëniet me zgjedhësit.

Mbledhja konstituive e Këshillit Redaktues të Projektit për hartimin e fjalorit me shpjegime

Të premten me 31 tetor 2003 Këshilli Redaktues i Projektit për hartimin e fjalorit me shpjegime mbajti mbledhjen e tij themeluese. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u miratuan metodologjia dhe Rregullorja e Punës.

KODI Analizat në Internet

Instituti për Hulumtim dhe Dokumentim (KODI) ka përgatitur një raport mbi punën e Kuvendit për periudhën prej zgjedhjeve të para të mbajtura në tetor të vitit 2001. Raporti ka për qëllim që të bëjë një analizë të funksionimit të qeverisë së tashme përmes analizës së punës së katër komisioneve parlamentare dhe të katër ministrive homologe: (i) Tregti dhe Industri, (ii) Punë dhe Mirëqenie Sociale, (iii) Ambient dhe Planifikim Hapësinor, dhe (iv) Arsim dhe Shkencë. Veç intervistave me ministrat përkatës dhe kryetarët e komisioneve, autorët intervistuan edhe këshilltarët e tyre, sekretarët ndërkombëtarë, koordinatorin dhe monitoruesin e Kuvendit nga Iniciativa për Mbështetje Kuvendit (ASI). Nga fundi i raportit, KODI jep edhe disa rekomandime gjithëpërfshirëse, të cilat synojnë ngritjen e efikasitetit të Kuvendit dhe të shkallës së bashkëpunimit në mes të institucioneve të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare. Raportin e plotë të KODI-it mund ta lexoni në web-faqen e KODI-it: www.kodi.ipko.net.

Shqyrtime publike mbi hartimin e legjislacionit

Friedrich Ebert Foundation (FES) dhe Institutit Nacional Demokratik (NDI) janë duke i harmonizuar përpjekjet e tyre për t'ju ndihmuar komisioneve përkatëse që të organizojnë shqyrtime publike për ligjin kundër diskriminimit dhe ligjin për shëndetësi.

NDI tani është duke përfunduar punën rreth doracakut mbi shqyrtimin publik. Një draft i doracakut i është dorëzuar të gjithë partnerëve të ASI-it për vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Shqyrtimet publike janë jashtëzakonisht të rëndësishme për funksionimin demokratik të një parlamenti dhe të komisioneve të tij, ngase ato u mundësojnë qytetarëve që të marrin pjesë në marrjen e qëndrimeve rreth çështjeve të caktuara dhe së këndejmi, i kontribuojnë zhvillimit të opinionit publik për vlerësimin e ndonjë qëndrimi apo problemi. Shqyrtimi i mëtejshëm publik ndikon në përmirësimin e cilësisë së hartimit të legjislacionit, përmes shkëmbimit të informatave, verifikimit dhe përcjelles së punës dhe problemeve nga fushat e caktuara me të cilat ballafaqohet qeveria.

Friedrich Ebert Foundation (FES) organizon një vizitë në Bosnje dhe Hercegovinë për Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale

FES ka vendosur që të organizojë një vizitë, prej datës 29 nëntor e deri me 3 dhjetor për disa deputetë të zgjedhur të Kosovës për të vizituar Parlamentin federativ të Bosnje dhe Hercegovinës, në kuadrin e "Programit rajonal të shkëmbime për parlamentarët", i cili mbështetet nga kontributet e qeverisë gjermane për Paktin e Stabilitetit. Bosnja dhe Hercegovina është zgjedhur për shkak të ngjajshmërive që ekzistojnë në sistemet, përvijat dhe mjediset, si dhe në kornizën e bashkëpunimit multienik, në të dy rastet. Me këtë rast, FES ka bashkëpunuar me Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe me Komisionin për Shëndetësi për shkak se ka vendosur të përqëndrohet pikërisht rreth çështjeve siç janë reformat sociale, shëndetësia dhe problemi i papunësisë. Këto çështje kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin e Kosovës. FES ka parashikuar që deputetët e Kosovës do të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i tyre me kolegët nga Bosnja dhe Hercegovina, në veçanti kur kemi të bëjmë me angazhimin e përbashkët të grupeve të ndryshme etnike për zgjidhjen problemeve të ndryshme.

Shkolla politike në Strasburg

Këshilli i Evropës prej datës 21 deri më 26 tetor 2003 organizoi një seminar për shkollat politike të Kosovës dhe të Bosnje dhe Hercegovinës. Në këtë ngjarje mori pjesë një delegacion që përbëhej nga anëtarë të të gjitha partive politike - me përjashtim të "Koalicionit Kthimi" (KP) - si dhe një numër i njejtë i përfaqësuesve nga OJQ-të. Ky seminar ishte i fundit në vargun e tri seminareve të organizuara nga shkollat politike të Prishtinës dhe Bosnje dhe Hercegovinës.

Kjo ngjarje u mbajt në qytetin e Strasburgut, i cili njihet si simbol i një vuajtje që zgjati për një shekull të tërë, për arsye se ndodhet midis dy fuqive evropiane, Gjermanisë dhe Francës, pra në zemër të Evropës.

Z.J.P. Kllain dhe Znj. Doris Pak lanë përshtypje jashtëzakonisht të mira tek pjesëmarrësit: ata që të dy e njohin mjaft mirë situatën politike në ish-Jugosllavi. Kështu, Z. Kllain ka punuar në Bosnjë dhe Hercegovinë nga viti 1997 deri në vitin 2002 dhe karrierën e tij e përfundoi si Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP), ndërkaq Znjsh. Doris Pak është anëtare e Parlamentit Evropian dhe e ka vizituar Kosovën disa herë gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Me këtë rast, ajo vuri në dukje: "Nuk po kërkojmë nga ju që ta doni shoqi shoin, por që të jetoni së bashku".

Z. Xhezair Murati, anëtar i grupit parlamentar "Komunitetet tjera" dhe bashkëkryetar i Vatan-it, gjatë prezantimit të tij u përqëndrua në qasjen e shumicës së zyrtarëve ndërkombëtarë, të cilët marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës i shohin përmes një prizmi bardhë e zi, duke shpërfillur kështu komunitetet tjera dhe rolin e tyre pozitiv në intergrimin në shoqërinë e Kosovës. Veç kësaj, me këtë rast u bënë të njohur edhe disa shembuj pozitivë, të cilët mund të shërbejnë si ndihmesë për ta tejkaluar situatën, që është duke mbizotëruar midis komuniteteve të ndryshme, por të cilat njëkohësisht provojnë se situata e tanishme është larg nga ajo që synohet.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësnyimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjuhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përkthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli per Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDL NJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikant Parlamentare Lindje-Përdim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Fotografitë e Buletinit:

OSBE (1, 3, 4, 6, 8, 9, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 20, 21, 22, 24), Lamers (f. 5), UNMIK-DPI (f. 13), Willert (f. 19).

ASI
Newsletter

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.de-vrieze@omik.org
http://www.osce.org/kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t